

URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE
BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE
NR.136 DHJETOR 2019

Frymë përjetësisht atdhetare



Faqe 4

Liria e besimit si shpresë



Faqe 8

**BABA SELIM GJIROKASTRA,
SIMBOL MIRËSIE**



Faqe 25

REDAKSIA:

KRYEREDAKTOR

Syrja Xhelaj

REDAKTORË

Nuri Çuni
Kujtim Boriçi

KORRESPONDENTËT

Jakup Gjoca - Greqi
Eugen Shehu - Zvicër
Përparim Kapllani - Kanada
Agim Cani - Gjermani
Enea Muhameti - Itali

KONSULENTË

Arian Leka
Zenel Anxhaku
Blerina Harizaj
Agim Zeka
Besnik Anxhaku

DESIGN

Studiograf "A&N"

**SHTYPET NË
SHTYPSHKRONJËN**

"Urtësia
Bektashiane"

Dhjetor, 2019



Frymë përjetësisht atdhetare



Ka qenë një bashkëpunim i Selisë së Shenjtë Bektashiane me Universitetin "Eqerem Çabej" të Gjirokastrës që nxori në pah vlerat atdhetare të tarikatit bektashian, të ngjizura me ngjarjet madhore të historisë së kombit.



10 | Nr. 130 | Dhjetor 2019

11 | Nr. 130 | Dhjetor 2019

12 | Nr. 130 | Dhjetor 2019

13 | Nr. 130 | Dhjetor 2019

Lutjet t'i mbështesim në realitetet që jetojmë

Më 14 dhe 15 nëntor 2019 është mbajtur në Baku, Samiti i Dytë i Liderve Fetarë Botërorë, nën kujdesin e drejtpërdrejtë të Presidentit të Republikës së Azerbajxhanit, Shkëlqesisë së Tij Ilham Alijev.

14 | Nr. 130 | Dhjetor 2019

14 | Nr. 130 | Dhjetor 2019

15 | Nr. 130 | Dhjetor 2019

16 | Nr. 130 | Dhjetor 2019

17 | Nr. 130 | Dhjetor 2019

Liria e besimit: Shpresë për tejkalimin e çdo realiteti

Me kërkesën e Tij, më 17 nëntor 2019, Emisari i Posaçëm i Presidentit Trump për Lirinë e Besimit, Ambasadori Sam Brownbach, bëri një vizitë në mjediset e Selisë së Shenjtë Bektashiane në Tiranë.

18 | Nr. 130 | Dhjetor 2019

19 | Nr. 130 | Dhjetor 2019

20 | Nr. 130 | Dhjetor 2019

21 | Nr. 130 | Dhjetor 2019

22 | Nr. 130 | Dhjetor 2019

Atdheu im i vetëm

Kur në majin e vitit 2016, së bashku me Kryegjyshin Botëror Bektashian, Hirësinë e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj shkua për të parën herë në atelien e tij, mu duk sikur ishim përpara një peizazhi baritor të trishtë, në gjoks të maleve.

23 | Nr. 130 | Dhjetor 2019

24 | Nr. 130 | Dhjetor 2019

25 | Nr. 130 | Dhjetor 2019

26 | Nr. 130 | Dhjetor 2019

27 | Nr. 130 | Dhjetor 2019


Solidaritët dhe humanizëm njerëzor

Qsh në orët e para të mëngjezit, të tërmetit të datës 26 nëntorit, Kryegjyshata Botërore Bektashiane me Seli në Tiranë jetoi minutat e humbjeve të mëdha njerëzore. Kryegjyshi, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj dërgoi mesazhin për të prekurit nga tërmeti dhe ngushëllime për familjet e viktimave.

28 | Nr. 130 | Dhjetor 2019

// Zhvillohet në Gjirokastrë simpoziumi me temë: “Karakteri kombëtar i besimit bektashian”

Frymë përjetës



Ka qenë një bashkëpunim i Selisë së Shenjtë Bektashiane me Universitetin “Eqerem Çabej” të Gjirokastrës që nxori në pah vlerat atdhetare të tarikatit bektashian, të ngjizura me ngjarjet madhore të historisë së kombit. I organizuar në mjediset e Universitetit “Eqerem Çabej”, në prani të klerikëve të lartë, Rektorit, si dhe intelektualëve të jugut të Shqipërisë, përmes fjalëve përshëndetëse dhe kumtesave, ju hodh dritë mbi rrugëtimin e bektashizmit, sidomos në dy shekujt e fundit, si dhe rolin të spikatur të jetës dhe veprës së baba Selim Gjirokastrës, i cili

75 vjet më parë pati kaluar nga kjo botë, duke u lënë trashëgim brezave të ardhshëm visare të mrekullueshëm të besimit.

Në fjalën e Tij, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj, pasi falënderoi të pranishmit, u kujtoi të gjithëve se veçanërisht në trevën e jugut të Shqipërisë, besimi bektashian kishte ardhur kurdoherë duke u rritur e zhvilluar, pasi ndjeshmëria e lartë e tij, besimi i përjetshëm tek Krijuesi, kishin qenë të pandarë prej trevave të Shqipërisë. Më tej ai shtoi: “....Kur flasim për traditën bektashiane në Jugun e


ar i tarikatit bektashian dhe kontributi i baba Selim Gjirokastrës //

Siisht atdhetare



Shqipërisë, vlen të marrim parasysh një varg kushtesh historike, përmes të cilëve ka kaluar lindja, zhvillimi dhe përhapja e tarikatit tonë. Sigurisht, ky tarikat nuk lindi në një tokë djerrë, përkundrazi shtresëzimeve të kulturave dhe feve të ndryshme, ishin shfaqur këtu, përpara se të shfaqej universalizmi Islam. Por mënyra se si besimi jonë u mboll dhe hodhi rrënjë, përveç të tjerave i takon urtësisë dhe tolerancës, bashkëjetesës vëllazërore që kemi manifestuar jo vetëm këtu në Jugun e Shqipërisë, por në krejt trevën ballkanike e më gjerë. Sot e kësaj dite, këta elementë përfaqësues të tarikatit tonë, sikundër

edhe tarikatet e tjerë të Islamit, kanë mundur të ruajnë një baraspeshë, për t'u admiruar në kontekstet fetarë shqiptarë. Studiues vendas dhe të huaj, kur flasin për bektashizmin ën këtë trevë, i drejtohen shpesh herë me të drejtë Ali Pashës, i cili ka qenë dhe mbetet jo thjeshtë një simpatizant i tarikatit tonë, por edhe kontributor në ngritjen e disa teqeve me emër dhe veprimtari shumëvjeçare. Por përpjekjet e tij, kanë qenë kurdoherë në harmoni të plotë me mendimin dhe guximin e baballarëve të teqeve, të cilët, ndonëse të edukuar dhe arsimuar në medresetë dhe mexhidet e perandorisë osmane, synuan në trevat shqiptare një perceptim të ri që do të lidhte besimin në Zot me besimin për një komb të ditur dhe të pavarur. Në mënyrë të veçantë, kjo ide u ngjiz në përpjekjet madhore të kombit tonë për autonomi. Në fund të shekullit 19 dhe në fillim të shekullit 20, objektet e teqeve tona u shndërruan në vatra diturie. Baballarët si: Ahmet Turani, Zenel Gjoksi, Ali Hakiu, Ali Tomorri, Meleq Shembërdhenji, Ibrahi Qesaraka, Abedin Leskoviku, Hysen Melçani etj, e patën kuptuar që në krye të herës se udha e besimit kalon përmes dashurisë për atdheun. Ata ishin po kaq të vetëdijshëm se zgjimi i një kombi do të vinte prej diturisë. Janë dhjetëra autorë të huaj që duke vizituar teqetë bektashiane në shekujt 19 dhe 20, kanë lënë faqe të shkëlqyera për atdhetarinë e shfaqur ndër klerikët tanë dhe padyshim, vlen të kumtohet më seriozisht se deri tani jo thjeshtë nga historiografia bektashiane, por edhe ajo shqiptare e ballkanike. Në kontekstin e mësipërm mund të thuhet se Teqeja e Zallit në Gjirokastër, ka luajtur një rol të spikatur si në edukimin e shkëlqyer atdhetar të brezave të myhibëve dhe dashamirësve, ashtu dhe në aspektin e këndimit të germave shqipe. Dokumentet historikë dhe rrëfimet e baballarëve tanë, flasin për



bastisje dhe kontrole të shumtë të veglave otomane në këtë teqe, por që për fatin e mirë të saj, si dhe për guximin e luftëtarëve të lirisë, ajo u shpëtoi mizorive të Portës së Lartë. Shembujt e shkëlqyer të baba Hakiut, të ndjekur paskëtaj nga baba Selimi, në rrafsh të ndërthurjeve harmonike të mësimëve të fesë, të moralit, me hallet e Shqipërisë, do të mbeten momente të gjalla të atdhedashurisë emblematike të tyre. Por edhe teqetë e Koshtanit, Turanit dhe Alipostivanit në Përmet, kanë dëshmuar që në vitet e para ët ngritjes dhe lulëzimit të tyre, se substanca e tarikatit bektashian, liria, është rrënjësor në breza të tërë besimtarësh. Ishin baballarët tanë që, së bashku me shpjegimin e situatave mistike, u përpoqën të mbillnin në shpirtrat e nxënësve të tyre dashurinë e pakufishme ndaj atdheut. Ata, me urtësinë e tyre proverbiale ngulitën tek ndjekësit e tarikatit mësimin e vyer se prijësit tonë, Hyqnar Haxhi Bektash Veliut, i cili tetë shekuj më parë porosiste: “Në dashtë i Larti Zot, se si janë veprat dhe gjendja e tillë e njerëzve, do ta kujtojnë në Mahsher, përmes rrugës së marifetit. Gjithsesi, nënshtrimi i robërve të Zotit është: të falin namaz, të agjërojnë, të japin zekatin, të shkojnë në Haxh dhe të marrin pjesë në luftë kur atdheu është në rrezik.” Pikërisht këto detyrime të tarikatit tonë përgjithësisht, por edhe të krejt myslimanëve, brezat bektashianë janë përpjekur t’i realizojnë kurdoherë

përmes përpjekjesh dhe sakrificash të panumërta. Të tilla detyrime, janë plazmat në indet e çdo vetëdije, duke bërë që dervishët dhe baballarët tanë, jo vetëm të shpërndanin urtësi, por edhe të merrnin dashuri prej ndjekësve të tyre shpirtërorë. Tani, pas 75 vitesh që ka kaluar nga kjo botë, ne vlerësojmë se vepra e Selim Gjirokastrës, do të mbetet kurdoherë frymëzuese në panteonin bektashian dhe kombëtar, pikërisht se ai nuk i ndanë asnjëherë punët e Zotit nga punët e kombit. Sigurisht, unë s’dua të mbetem gjatë këtu, sepse rreth misionit të baba Selimit, do të dëgjojmë në këtë sallë, vëllanë tonë, baba Sadik Ibrun. Është shumë e vërtetë se organizimi i eventeve të tillë, në kujtim të ngjarjeve apo të veprave të klerikëve tanë, nuk na shërben thjeshtë si një moment respekti për ët kaluarën. Mendoj se përkujtime të tilla, duhet të na vlejnë edhe si momente reflektimi të thellë për atdhetarinë që aktualisht rrëfejme. Sepse vështirësitë e sotme, të gjithë i dimë. Sepse varfërinë e sotme, të gjithë e shohim. Sepse shpresën e vvarë, të gjithë e kemi brenda shpirtit. Por a ja vlen të braktisim këtë

Hyqnar Haxhi Bektash Veliut, i cili tetë shekuj më parë porosiste: “Në dashtë i Larti Zot, se si janë veprat dhe gjendja e tillë e njerëzve, do ta kujtojnë në Mahsher, përmes rrugës së marifetit. Gjithsesi, nënshtrimi i robërve të Zotit është: të falin namaz, të agjërojnë, të japin zekatin, të shkojnë në Haxh dhe të marrin pjesë në luftë kur atdheu është në rrezik.” Pikërisht këto detyrime të tarikatit tonë përgjithësisht, por edhe të krejt myslimanëve, brezat bektashianë janë përpjekur t’i realizojnë kurdoherë përmes përpjekjesh dhe sakrificash të panumërta.

vend, këto teqe, këtë histori? Mos ndoshta ja vlen të luftojmë të gjithë së bashku, për më të mirën e kësaj toke, edhe pe ne duhet të bëjmë sakrifica? Besoj se



vlerash të përbashkëta. Duke u ndalur paskëtaj në atë lloj atdhetarizmi të dukshëm të bektashinje në lëvizjen për liri të shqiptarëve, sidomos në trevat e jugut, z. Islami solli shembuj nga veprimtaria e gjerë e teqesë së Zallit në Gjirokastrë dhe veçanërisht nga jeta e baba Selim Gjirokastrës. Në fund të përshëndetjes, ai falënderoi organizatorët për kujdesin që tregojnë në edukimin e brezave të rinj, ku veçanërisht tradita Islame ka vendin e vet të merituar.

Në emër të Bashkisë Gjirokastrë, përshëndeti

z. Kudret Aliko, i cili nënvizoi idenë se koha për atdhetarizëm jo vetëm nuk ka kaluar, por përkundrazi, në proceset evropiane ku duhet të përfshihemi, kjo kohë vlen të sjellë ndërmend ata burra të shquar, ata

po. Besoj se duhet ët na bashkojë Shqipëria jonë me halle. Po të jemi të bashkuar ën idenë se Shqipëria është e jona dhe se shqiptarë të ndershëm dhe të zgjuar kemi plot, shpresoj se edhe politikanët do të mendohen më thellë se të hedhin hapat e tyre...”

Ndërsa Rektori i Universitetit “Eqerem Çabej”, Prof. Dr. Bektash Mema, në përshëndetjen e tij tha midis të tjerave se një bashkëpunim i tillë, midis dy institucioneve, Selisë së Shenjtë Bektashiane dhe Rektoratit të Universitetit, marrin vlera gjithnjë e më të mëdha dhe ndikojnë ndjeshëm në paqëtimin e njerëzve dhe sidomos në edukimin e brezit të ri. Ai falënderoi Selinë e Shenjtë, për një varg aktivitete të tillë në Gjirokastrë, si shenjë vlerësimi për tiparin atdhetar të bektashizmit në këtë trevë.

Ndërsa myftiu i Qarkut të Gjirokastrës, Haxhi Armand Islami, duke uruar këtë bashkëpunim dinjitoz të Selisë së Shenjtë Bektashiane me Rektoratin e Universitetit, tha se

kur veprimtari të tilla gjejnë jehonë ën botën studentore, vlerat e tyre sigurisht janë shumë të mëdha. Ato vlera rrezonojnë në kohë dhe sidomos në këto ditë, ne kemi nevojë më shumë se kurrë që besimin Islam ta konsiderojmë si një univers





klerikë aq të nderuar që vunë jetët e tyre në shërbim të Zotit dhe të kombit. Ndërsa gjyshi i gjyshitës Gjirokastër, baba Skënder Dervishi, në fjalën e tij u ndal në mënyrë të veçantë në rolin e padiskutueshëm të teqeve dhe prindërve të jugut të Shqipërisë, të cilat përmes frymës atdhetare që shpërndanë, u shndërruan në vatra edukimi të brezave të besimtarëve. Kjo frymë, e cila u mbajt gjallë nëpërmjet klerikëve bektashianë, konkludoi së fundmi baba Skënderi, ka qenë dhe mbetet dëshmi e ndjenjave të kthjellëta liridashëse të krejt popullit të kësaj



treve, gjë që përveç krenarisë na bën sot më të përgjegjshëm ndaj sfidave. Panelin e kumtesave të këtij aktiviteti, e çeli baba Sadik Ibro, i cili solli në fjalën e tij, aspektet më të rëndësishëm të veprës klerikale të baba Selim Gjirokastrës. Përmes një

analize plot sqimë, përmes meditimeve në kontekste të ndryshëm kohorë dhe sidomos përmes një tentative për të zbuluar filozofinë e këtij patriarku të mendimit bektashian, baba Sadik Ibro, mundi të hedhë dritë mbi tiparet më të vyera të klerikëve tanë, duke u ndalur vetmas në temperamentin e baba Selim Gjirokastrës. Një kronologji kodesh zakonore, ndoqi pothuaj gjithë kumtesën, prej nismave të Pirit tonë, Haxhi Bektasha Veliu, deri në bektashizmin e trojeve shqiptarë në shekullin që lamë pas.

Kumtesën e Prof. Dr. Shyqyri Hysit, rreth veprimtarisë së gjerë fetare dhe atdhetare të teqesë së Zallit, e paraqiti në këtë veprimtari z. Hysi, i cili tha midis të tjerave: “Teqeja e Zallit është ndër më të vjetrat në Shqipëri dhe njihet për veprimtarinë e saj të gjerë fetare, shoqërore, politike e humanitare. Burime të ndryshme dokumentare, literatura e mirëfilltë historike si dhe materiale arkivore e bibliografike, hedhin dritë mbi historinë dhe faktorët që sollën formimin e saj. Një fragment i marrë nga vepra “Misticizma Islame” e baba Rexhepit, i cili ka shërbyer si dervish i baba Selimit, konfirmon ardhjen e klerikëve të ndryshëm në Gjirokastër. Ndër ‘ta përmendet baba Arshiu, tyrbja e të cilit ndodhet edhe sot në lagjen Çfakë. Prezenca e tij i përket fillimit të shek. XVII (1620), kohë e cila i paraprin shkrimeve të Evlia Çelebiut që shkruan: “...në vitin 1670 ekzistonin 2 teqe në Gjirokastër”, njëra prej të cilave është teqeja e Zallit. Baba Rexhepi, gjithashtu shkruan për baba Hasimin si themelues i kësaj teqeje: “Muhamed Hasim Babai është një nga udhërrëfënjësit e shquar bektashian dhe shkrimtar i devotshëm, i pajisur mirë me kulturë dhe hierarkinë fetare, u dërgua me gradën gjysh, nga teqeja e Haxhi Bektashit në Shqipëri

më 1778 dhe erdhi në Gjirokastër për të përhapur bektashizmin në këtë qytet. Pas dy vjetëve që rrinte në çadër, themeloi teqenë e tij pikërisht me 1780”. Në një material i perkthyer te vitit 1923, që gjendet në Arkivin e Institutit të Historisë (A. I. H.) theksohet: “Teqeja e baba Hasimit në anën tjetër të Gjirokastrës, u themelua këtu e 200 vjet të kaluar dhe dihet si një nga më të vjetrat në Shqipëri. Themeluesi dhe pasuesi i tij ndodhen të varrosur secili në çdo anë të portës”. Pra flitet për tyrbet e baba Hasimit dhe baba Ali Plakut, ndërtuar respektivisht në fund te shek. XVIII dhe në fillim te shek. XIX. Pra sipas këtij shkrimi, teqeja e Zallit u formua rreth vitit 1720. Pavarësisht viteve relativisht të ndryshme të këtyre materialeve mbi themelimin e teqesë së Zallit, duke marrë parasysh faktet e cituara me lart, mund të dalim në konkluzionin se; teqeja e Zallit u themelua prej baba Hasimit, si një seli qendrore (gjyshate) në shek. XVIII. Ndërtim ishte i domosdoshëm për t’iu përgjigjur nevojës së numrit të lartë të besimtarëve për një institucion fetar të mirëfilltë. Ky ndërtim, mund të shihet si fryt i një faze parapërgatitore e cila nis me misionarët që në shek. XIV e deri në intensifikimin e saj me ardhjen e jeniçerëve (fillimi shek. XVI), të cilët predikonin pikërisht besimin bektashian. Duke iu referuar dokumenteve gjatë rrjedhave të shekujve, teqeja e Zallit, rezulton se është drejtuar nga këta baballarë: baba Hasimi, baba Hasan Turku, baba Ali Gega (Plaku), baba Haxhi Jahaj, Ibrahim baba Turku, baba Hysen Elbasani, baba Haxhi Ali Haki, baba Selimi, baba Ali Tomori, baba Sherif Canometri, baba Ibrahim Kuka, Abedin baba, baba Neki Levani, baba Haxhi Salia etj... Po ashtu, kanë shërbyer edhe dhjetëra dervishë e myhyb. Midis dervishëve që kanë



Panelin e mbylli studentja e historisë në Universitetin “Eqerem Çabej”, Xhevahire Tosuni, e cila duke marrë shkas nga historiku i ndritur i teqesë së Melanit, u ndal në mënyrë të veçantë në rolin e dyzuar të baba Qamil Gjinit. Parë në kontekstin kohor, Tosuni tha midis të tjerave: “Baba Qamili lindi në fshatin Matogjin pranë Smokthinës së Vlorës rreth vitit 1870. Që i vogël shquhej për dashurinë ndaj çdo krijese të Zotit dhe që tepër korrekt në sjelljet me njerëzit. Duke vizituar teqenë e Smokthinës dhe rrëfimet e baballarëve dhe dervishëve bektashianë i hyri në shpirt dashuria për Haxhi Bektash Velinë edhe Ehlibejtin e shenjtë. Asaj kohe në atë krahinë kishte edhe njerëz që nuk besonin në fe dhe bektashiu i vogël u mërzi nga ai ambient edhe tha:

“Moj teqeja në Smokthinë/ Më marsh hakën o Allah...”. Duke parë dëshirën e djalit, babai i tij e shpie në teqen e Sejid Asim Babait në Gjirokastrë ku drejtonte baba Ali Gjirokastra. Vëllai i tij Aliu u bë muhib i baba Aliut dhe vinte shpesh te baba Aliu për të vëllanë që rritej e burrërohej pranë këtij kleriku e atdhetari të lartë. Qamili i ri merr dorë tek baba Aliu dhe bëhet muhib e dervishi i tij rreth vitit 1890. Në teqe mësohej në mësonjëtoreshkrimi e lexim në shqip, arabisht e turqisht. Të mos harrojmë se teqet e jugut të Shqipërisë në fund të shek. XIX duke filluar me teqenë e Sevasterit, të Hekalit, të Krahësit, të Turanit, të Kalivaçit, të Gjirokastrës dhe deri te teqeja e famshme e Zallit, e kishin përcaktuar misioni e tyre tepër të pandarë nga brengat e Shqipërisë. Feja dhe atdheu kanë qenë një binom emblematik që kanë shoqëruar kurdoherë fenë e vlerave dhe në mënyrë të veçantë tarikatin tonë bektashian. Në kodin zakonor shqiptar është shkruar me germa të arta

shërbyer, evidentohen emrat e: dervish Muhamet Golemi, dervish Rexhep Beqiri, dervish Esati, dervish Barjami, dervish Shazivari, dervish Shahini, dervish Hyseni, dervish Hasani (Liapi), dervish Safeti, dervish Zeneli, dervish Muharremi, dervish Xhafer Zhapokika, dervish Shahin Progonati, dervish Aliu, dervish

roi jetë më 16 tetor 1944. Ai mori drejtimin e teqesë së Zallit në vitin 1907. Kontributin e këtij atdhetari e kleriku me një forcë të madhe mistike, e kanë vlerësuar disa personalitete vendas dhe të huaj si Mihal Grameno, Bajo e Çerçiz Topulli, baba Ahmet Turani, baba Sulejman Kardhiqi, Mbreti Zog, si edhe studiuesi i shquar, Franz Babinger. ...Midis figurave kombëtare gjatë periudhës 1912-1948, rreshtohet me dinjitet edhe baba Aliu. Ky klerik, u ekzekutua nga regjimi komunist në vitin 1948. Baba Sherif Canometi, ishte gjysh i zonës së Gjirokastrës gjatë viteve 1949-53 dhe 1991-1994. Ai kishte një forcë të madhe mistike, intelektuale e atdhetare. Me reputacionin e tij në popull, baba Sherifi, arriti të kultivoje e të mbaj gjallë frymën e besimit bektashian edhe në vitet e monizmit. Në shtëpinë e tij, atje në Zaranikë të Elbasanit, kandili i Haxhi Bektashit, nuk u shua. Baba Sherifi është iniciatori i rihapjes së teqesë së Zallit duke dërguar në korrik 1991, baba Nekiun. Ai pati një korrespondencë të vëllazërore me baba Rexhepin, e cila është botuar në librin “Mision Bektashian në teqenë e Zallit”.



Llacia etj....Baba Selimi, ishte i njohur jo vetëm si klerik mistik, por edhe si një patriot në të gjithë popullsinë e trevës, pavarësisht besimit. Ky lindi në Elbasan në vitin 1869 dhe ndër-



se “shtëpia e shqiptarit është e Zotit dhe e mikut.” Prandaj edhe teqetë tona, sa të Zotit kanë qenë edhe të miqve që rrinin larg dhe mbeteshin të mrekulluar prej dervishëve dhe baballarëve bektashianë. Baba Aliu e dekretoi baba edhe e dërgoi të



zëvendësonte baba Sejfulla Melanin në teqenë e Melanit pasi ishte plakur. Baba Qamili punoi që të forconte teqenë që në sofrën e saj të kishte vend besimtarë, atdhetarë, fakirfukarë, udhëtarë dhe çdo njeri i mirë që e vizitonte. Krijoi marrëdhënie të mira me besimtarët në Libohovë, Nepravishtën e Poshtme deri edhe me të krishterët ortodoks të Vllaho-Goranxisë, Lugarit, Frashtanit e priste bujarisht në teqe. Një kontribut i madh i baba Qamilit është edhe gjatë Kongresit II Bektashian që u mbajt në Gjirokastrë pas atij të Prishtës. Siç dihet në këtë kuvend bektashian u analizua periudha nga Prishtë e vitit 1921 deri në 1924 në të cilat ky besim erdhi duke u rritur

dhe zhvilluar falë devotshmërisë së klerikëve dhe dashurisë për atdheun që ata shpërndanin. Mjaft influencë dhe dashamirës bektashian gjatë zhvillimeve të Kongresit bujtën në Teqenë e Melanit dhe u pritën me bujarinë karakteristike të baba Qamilit. Sipas dokumenteve të kohës, baba Ali Tomorri më 12 korrik 1924 bëri me dije shqiptarët me anë të një telegram se: “kuvendi i bektashianëve u mbledh në Gjirokastrë dhe morri vendime që të bëhen reforma në dogmën bektashiane. Reforma do të bëhet siç e kërkon koha e sotme, përparimtare siç e do interesi kombëtar dhe si e lejon feja muhamedane e cila në themel e në parim është fe njerëzore. Baba Qamili si klerik dhe atdhetar përkrahu qeveritë kombëtare shqiptare. Mendohej të qetësonte shpirtat e zemrat e besimtarëve. Priti me urrejtje pushtimet e huaja nazi-fashiste dhe në pushtimin grek të 1940, i shpëtoi për mrekulli një veprimi terrorist ushtresë greke dhe u strehua te besimtari Selami Katarua në Nepravishtë. Kur filloi lufta vëllavrasëse në Libohovë që ndezi flakën e luftës civile në mbarë Shqipërinë baba Qamili u dëshpërua shumë. Vrasjen e 23 vetëve nga Glina e Gjirokastrës, e prit me dëshpërim të thellë dhe i mallkoi vrasësit. Duke qenë edhe

në një moshë madhore, duke mos e duruar plagën e vëllavrasjes me lot në sy tha: “Paçin belanë ata që e filluan vëllavrasjen.” Ndërroi jetë më 14 nëntor 1943, i përcjell në banesën e tij të fundit me dashuri e respekt nga gjithë krahina e rrëzës zë zezë, bektashian e të krishterë se Baba Qamili kishte bërë fole në zemrat e tyre. Pas kalimit nga jeta e baba Qamilit, në teqenë e Melanit shërbyen të tjerë dervish e baballarë, jeta dhe vepra e të cilëve u dëshmuar se këta ecin në gjurmët e paraardhësve të tyre. Fryma e shenjtë e bektashizmit ajo frymë që mbajti gjallë e të pa fikur qiririn e Haxhi Bektash Veliut, mbështolli në ngrohtësinë e saj breza të tërë të besimtarëve libohovët, të cilët ende sot ruajnë kujtimet më të bukura nga teqeja e Melanit. Në këtë teqe prej vitesh shërben e punon dervish Myrteza Shehu dhe pa dyshim fryma bektashiane do të përcillet më tej akoma. Gjej rastin këtu, nga kjo sallë, t’u përcjell klerikëve tanë bektashinj urimet më të mira në realizimin e misionit fisnik të tyre si edhe në emër të brezit adhurues të përjetshëm të këtij tarikati kaq tolerant dhe atdhetar.”

Veprimtarinë e mbyllën bisedat e gëzuara dhe një koktejl i organizuar me këtë rast.

Koresp. “Urtësia”



// Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, //
përhëndet Samitin e Liderve Botërorë Fetarë në Azerbajxhan

Lutjet t'i mbështesim në realitetet që jetojmë

Më 14 dhe 15 nëntor 2019 është mbajtur në Baku, Samiti i Dytë i Liderve Fetarë Botërorë, nën kujdesin e drejtpërdrejtë të Presidentit të Republikës së Azerbajxhanit, Shkëlqesisë së Tij Ilham Alijev. Lider të lartë fetarë nga gjithë bota, për dy ditë me radhë, në analizë të situatave gjeopolitike dhanë përmes shembujve dhe përvojave të tyre, ide dhe rrugëzgjdhje të mundshme që lidhen me rolin e pakontestueshëm të fesë në zhvillimet e derisotme. Është e vërtetë, u theksua në këtë samit ndërkombëtar se bota e sotme po ecën përpara me ritme të paimagjinueshme, por është po kaq e vërtetë se kur flitet për besimin tek Krijuesi, tendencat dhe barrierat bëhen çdo ditë e më kërcënuese, duke manifestuar keqpërdorime të lirive fetare dhe atyre njerëzore. Ndjeshëm në kësi rastesh, vlen të ngrihet në stade më të përparuara, vet të tjerave edhe kontributi i liderve fetarë, të cilët me vizionin e tyre ndikojnë në kapërcimin e sfidave.

Në ditën e parë të këtij samiti, pas këndimit të një sureje kur'anore, kanë dhënë mesazhet e tyre të paqes dhe shpresës” Presidenti i Azerbajxhanit Alijev, lideri Seikhul-Islam Allahshuku Pashazadeh, Patriarku i Lartë i Moskës, Kirill, Përfaqësuesi i Lartë i Aleancës së Qytetërimeve në Kombet e Bashkuar, Miguel Angel Moratinos, Udhëheqësi i Republikës Çeçene, Ramazan Kadirov, Kryerabini i Izraelit Shlomo Amar, Sekretari i Përgjithshëm për Çështjet Humanitare të Kuvajtit, Abdallah Al

Matoug, Presidenti i Emirateve të Bashkuara Arabe për Çështjet Fetare, Abdurrahman El Hashim, si edhe personalitete të tjera të lartë. Fjalët e të mësipërme u përcollën me duartrokitje të të gjithë të pranishmëve që mbushnin sallën. Pas këtij paneli, të ftuarit u njohën me disa ide se si Azerbajxhani ka promovuar multikulturalizmin, tolerancën dhe solidaritetin e besimit. Në ditën e dytë, kumtoi gjithashtu Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili bëri një ekspozitë të

sfidave fetare në Ballkan, tha midis të tjerave:

“Të nderuar organizatorë të këtij event, në të mirë të paqes Botërore! Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë të marr pjesë në këtë veprimtari dhe më lejoni t’ju uroj në emrin tim personal, si dhe në emër të bektashinjve në të gjithë botën: Zoti i Lartë ju plotësoftë çdo dëshirë Ju, familjeve Tuaja shpirtërore, kombeve Tuaj! Samiti i sotëm, i mbajtur në kuadër të festimeve jubilarë të Sheh-ul-Islam Allahshukur Pashazade, sigurisht është një mundësi tjetër e jona, jo vetëm të takohemi me njeri-tjetrin, jo vetëm të flasim rreth atyre që “na dhembin në shpirt”, por edhe të paracaktojmë udhët

e mrekullueshme myslimane, përgjatë shekujve ka rrëfyer shfaqje të pafund të mëshirës, të dialogut, të mirëkuptimit njerëzor dhe fetar, sepse në substancë të besimit tonë, është pikërisht kjo tolerancë që na ka ushqyer ndër breza. Në këtë sallë, të gjithë e dimë se në vitin e tretë Hixhri, kur Profeti ynë i bekuar hyri në Mekë, të gjithë jobesimtarët u fshehën apo

donin të merrnin arratinë prej gjithë atyre të këqijave që u patën bërë myslimanëve. Por Profeti ynë, lajmëtari i besimit të Allahut të Lartë, duke manifestuar si gjithmonë idetë e mëshirës dhe të dashurisë midis njerëzve, i tha krejt popullit: “O njerëz! Ne vërtet ju krijuam ju prej një maskulli dhe

sendërtuar jo thjeshtë themelet e saj, por krejt atë ngrehinë të çmuar, të ndriçuar nga Islami. Ideja e paqes në të dy botët, mishërimi i mishërimi i një vëllazërie përtej ngjyrave, racave apo feve, respekti i thellë dhe i vetëdijshëm për natyrën dhe Krijuesin e saj, bënë të mundur përparimin e fesë sonë si edhe përqaftimin e saj sot, në më shumë se një miliard besimtarë. Madje edhe kur u anatemua dhe u sulmua në vende dhe kohë të ndryshme, tradita Islame u shfaq kurdoherë koherente me tiparet më të qenësishme të saj dhe në mënyrë të veçantë me mëshirën universale. ..Ne të gjithë jemi të ndërgjegjshëm për sfidat që kalon sot shoqëria njerëzore, sfida që nëse nuk peshohen në “kandarin” e shpirtit, do të na vënë përpara dramave të paparashikuara. Kohërat që po kalojmë, po bëjnë çdo ditë e më shumë evidentë problemet që ne kemi me natyrën, duke harruar në shumë raste se kjo dhuratë e Krijuesit nuk mund të shpërdorohet sipas orekseve të oligarkëve famëkeq. Ne kemi problem me largimin e rinisë prej objekteve të kultit, të joshur padyshim nga globalizmi dhe praktikiteti shekularist. Ne kemi probleme me varfërinë e miliona të uriturve përballë indiferencës së milionerëve apo shoqërive “moderne”, të cilat anashkalojnë të drejtën për të jetuar, sikundër vlen të jemi të gjithë të ndjeshëm ndaj luftërave rajonale që po marrin çdo ditë qindra e mijëra jetë të pafajshme.

Krejt këto sfida, janë sigurisht të ndërlikuara dhe kërkojnë jo vetëm kapacitete të fuqishëm për t’u kapërcyer, por dhe një ndërveprim të përhershëm dhe energjik



tona për përballimin e sfidave. Ne kemi pasur e do të kemi gjithmonë nevojë për fjalën e njeri-tjetrit, sepse është fjala ajo që na ka zbritur me madhështinë e saj të përjetshme prej Librave të Shenjtë, është fjala e Zotit ajo që na jep kuptimin e vërtetë të jetës së sotme dhe asaj të ahiretit. Është fjala ajo që na bashkon në këtë botë diverse. Familja jonë e madhe dhe

një femre, ju bëmë popuj dhe fise që të njiheni mes njeri-tjetrit, e s’ka dyshin se tek Allahu i Lartë, më i ndershmi nga ju, është ai që u ruhet më shumë mëkateve, e Allahu është i dijshtëm dhe njeh gjithçka deri në imtësi” (Kurani, 49:13). Nuk ka dyshim se një substancë e tillë ndijmore, siç është vëllazëria njerëzore, e ka shoqëruar familjen myslimane përgjatë shekujve, duke

të qeverive dhe lidërshiptit politik botëror. Por ajo që unë personalisht mendoj, është që roli ynë, roli i liderve fetarë, më shumë se deri sot, duhet të jetë i ndjeshëm dhe kontribuues, pikërisht në idenë se përpara çdo mekanizmi ekonomik, politik apo social, ne duhet t'i kërkojmë ndihmë Zotit. Lutjet tona, të mbështetur në realitetet e sotëm, të dala prej shpirtit të pastër, të shumëfishuara në dimensionin njerëzor të miliarda besimtarëve, besoj se do të kontribuojnë në kapërcimin e krizave të sotme. Meqenëse aktualisht, unë udhëheqë tarikatit bektashi, më lejoni t'ju them se ky tarikat, që në lindje të tij para tetëqind vjetësh e deri më sot, është shpërndarë ndër besimtarë anë e kënd botës, si një frymë vëllezërie e përjetshme. Komunitetet bektashiane, deri më sot të identifikuara në 31 vende, nga Azia në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kanë mundur të identifikojnë veten e tyre si të barabartë dhe vëllezër me çdo komunitet tjetër fetar,

kurdoherë përmes dashurisë dhe devocionit të thellë të tyre ndaj Islamit dhe ndaj Haxhi Bektash Veliut. Prej gati nëntë dekadave, Selia e Shenjtë Bektashiane është shpërngulur nga Turqia, për t'u vendosur në Tiranë-Shqipëri dhe ky shekull ka dëshmuar se ne mbetemi të ndërgjegjshëm për misionin historik, jo thjeshtë ndaj besimtarëve, por në radhë të parë për përparimin e Islamit, në Ballkan e më gjerë. Ne do të kontribuojmë deri në rrahjen e fundit të zemrës, për universalitetin e Islamit dhe paqes njerëzore."

Gjatë dy ditëve të zhvillimit të Samitit në Baku, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, zhvilloi takime me përfaqësues të lartë fetarë dhe shtetërorë, pjesëmarrës në këtë event. Të tillë sihin: Syed Zafar Mahmood, President i Koalicionit për Paqe në Indi, Robert Mobili, Përfaqësues i Komunitetit të Krishterë të Azerbajxhanit, Dr. Ebrahim Ebrahimi, Rektor i Universitetit në Tabriz,

Martin Palmer, Lider i Dialogut të Civilizimeve në

Austri, Ravil D. Pançev, Myftiu i Shën Petërburgut, Ali Aldabbugh, Ambasadori i Irakut në Baku, si dhe personalitete të tjerë. Kryegjyshi Botëror Bektashian i njohu të pranishmit me historinë e Bektashizmit dhe veçmas me atë të shekullit të njëzetë, që lidhet me vendosjen në Tiranë të Qendrës Botërore, pas sulmeve të ashpër të ndërmarrë nga shteti turk i asaj kohe. Sfidat që ky tarikat kapërceu në trojet shqiptare, por dhe në krejt Ballkanin e më gjerë, ishin gjithashtu temat e këtyre bisedave ku nuk mungoi interesimi i të gjithëve për zhvillimet e sotme bektashiane. Edhe në këtë kontekst, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, iu përgjigj interesimit të bashkëbiseduesve, duke nxjerrë në pah sidomos vlerësimet e të huajve për misionin historik që po vijon Selia e Shenjtë Bektashiane.

Koresp. "Urtësia"



Emisari i Posaçëm i Presidentit Trump për Lirinë e Besimit, Ambasadori Sam Brownbach, vizitë në Selinë e Shenjtë Bektashiane

Liria e besimit: Shpresë për tejkalimin e çdo realiteti

Me kërkesën e Tij, më 17 nëntor 2019, Emisari i Posaçëm i Presidentit Trump për Lirinë e Besimit, Ambasadori Sam Brownbach, bëri një vizitë në mjediset e Selisë së Shenjtë Bektashiane në Tiranë. Ai u prit nga Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili e falënderoi për vizitën, duke i shprehur ndërkaq edhe urimet më të mira ndaj

optimizmi. Vizita vijoi më tej në mjediset e odeonit shumëdimensional të Selisë së Shenjtë Bektashiane, ku Ambasadori Sam Brownbach, u njoh jo vetëm me historikun më shumë se 800 vjeçar të tarikatis tonë, por edhe me kodet zakonorë, traditat dhe sidomos vlerat e mëdha të bektashizmit në trojet shqiptare. Ai u njoh me ngjarjet më të rëndësishme të Qendrës Botërore Bektashiane dhe u interesua sidomos në

Është e njohur tanimë botërisht, se vendosja e Qendrës Botërore Bektashiane në Tiranë, u shoqërua jo vetëm thjeshtë me vëmendjen e qeverisë turke të kohës, por edhe me një varg zhvillimesh në teqetë brenda trevave shqiptare, që tarikati të ruante të pacënuara vlerat thelbësore të tij, madje të çlirojë prej çdo lloj dogme anadollake.



Kombit të Amerikës. Ardhur në Tiranë në kuadër të Konferencës Ndërkombëtare me idenë “Feja si instrument për paqen”, Ambasadori Brownbach, qysh në fillim të bisedës vuri theksin në rolin konsistent të feve për realizimin e një paqeje sa më universale dhe të qëndrueshme. Fryma përmes së cilës, besimi fetar krijon vlera dhe ndjesi të mrekullueshme, ka bërë që shoqëria njerëzore të ruaj ekuilibrat shpirtërorë të domosdoshëm, veçanërisht në etapat e sotme të saj. Përmes kësaj fryme, ne do të donim t’i shihnim realitetet kurdoherë me një ndjesi më të thellë

mënyrën se si janë kapërcyer sfidat e shumta të këtij tarikati të Islamit. Nga ana e Tij, Kryegjyshi Botëror Bektashian, të mbijetesës bektashiane në kushtet e shtresëzimeve fetare dhe kulturore të Azisë në shekujt 15-18, ku ndonëse ekzistonin me qindra tarikate, pak prej tyre mundën të mbijetojnë në mozaikun e konteksteve historikë. Falë substancës bazike të këtij besimi, tolerancës ndaj tjetrit ‘ndryshe’, bektashizmi është kurdoherë duke u rritur e zhvilluar, duke predikuar urtësi e paqe për çdo besimtar,

sepse të një Zoti jemi të gjithë dhe devotshmëria e çdokujt prej nesh, matet me veprën e tij të urtësisë dhe dashurisë që rrëfen ndaj robërve të Zotit.

Më tej, Kryegjyshi Botëror Bektashian, e njohu Ambasadorin Sam Brownbach, me goditjet që tarikati bektashian, mori njëra pas tjetrës, në periudhën 1826-1926, goditje të cilat çuan në rrënim të plotë mijëra tyrbe dhe teqe bektashiane, pa lënë mënjanë numrin e madh të klerikëve të pafajshëm që u vranë, dënuan apo internuan nga perandoria otomane. Pikërisht, në këto momente delikate për vetë ekzistencën e bektashizmit, shkëlqen

vepra kuptimplote e klerikut dhe atdhetarit të madh, Sali Niazi Dede, i cili në marrëdhënie të ngrohtë me shtetin shqiptar të kohës, bazuar edhe në të drejtat që i garantonte kodi zakonor i teqesë së Nev-Shehir të Turqisë, duke marrë edhe pëlqimin e liderëve bektashianë kudo ku jetonin këto komunitete, mundi të vijë përgjithmonë në Shqipëri. Është e njohur tanimë botërisht, se vendosja e Qendrës Botërore Bektashiane në Tiranë, u shoqërua jo vetëm thjeshtë me vëmendjen e qeverisë turke të kohës, por edhe me një varg zhvillimesh në teqetë brenda trevave shqiptare, që tarikati të ruante të pacënuara



... Besimtarët bektashianë të sotëm, përpigën në çdo moment të jenë të kujdesshëm dhe fleksibël që parimet e Islamit, mësimet e Profetit Muhamed, apo thëniet filozofike të Haxhi Bektash Veliut, të mos mbeten vetëm në peizazhet teorikë apo filozofikë, por të depërtojnë në çdo qelizë të jetës dhe veprës së tyre, duke qenë në harmoni dhe vëllazëri të plotë, jo vetëm me familjen e tyre shpirtërore, por edhe me besimtarë të feve të tjera. Është fakt i pamohueshëm që bektashizmi, jo vetëm në trojet shqiptare por dhe në Ballkan e më gjerë, duke luajtur rolin e madh pajtues të tij, ka mundur të rrisë ndërveprimin fetar në kahjen e tolerancës fetare, në luftë me çdo shfaqje apo barrierë të keqpërdorimit të Islamit. "Ne jemi të ndërgjegjshëm, u shpreh së fundi Kryegjyshi Botëror Bektashian, se nuk kemi arritur gjithçka në perfeksion, por së paku nuk na kanë munguar në asnjë rast, as shqetësimi i natyrshëm njerëzor dhe as intuita e vendosmëria fetare, për t'u përballur me sfidat, sado të vështira të jenë ato.

vlerat thelbësore të tij, madje të çlirojë prej çdo lloj dogme anadolake.

Lidhur me interesimin e Ambasadorit Sam Brownbach, për angazhimet e sotme të Selisë së Shenjtë, në konceptin e ushtrimit të lirive fetare, Kryegjyshi Botëror solli shembuj të shumtë se si nëpër mjediset e teqeve tona, ajo liri shkon përtej riteve apo kodeve të trashëguara si traditë.

E thënë ndryshe, besimtarët bektashianë të sotëm, përpiqen në çdo moment të jenë të kujdesshëm dhe fleksibël që parimet e Islamit, mësimet e Profetit Muhamed, apo thënie filozofike të Haxhi Bektash Veliut, të mos mbeten vetëm në peizazhet teorikë apo filozofikë, por të depërtojnë në çdo qelizë të jetës dhe veprës së tyre, duke qenë në harmoni dhe vëllazëri të plotë, jo vetëm me familjen e tyre shpirtërore, por edhe me besim-

tarë të feve të tjera. Është fakt i pamohueshëm që bektashizmi, jo vetëm në trojet shqiptare por dhe në Ballkan e më gjerë, duke luajtur rolin e madh pajtues të tij, ka mundur të rrisë ndërveprimin fetar në kahjen e tolerancës fetare, në luftë me çdo shfaqje apo barrierë të keqpërdorimit të Islamit. “Ne jemi të ndërgjegjshëm, u shpreh së fundi Kryegjyshi Botëror Bektashian, se nuk kemi arritur gjithçka në perfeksion, por së paku nuk na kanë munguar në asnjë rast, as shqetësimi i natyrshëm njerëzor dhe as intuita e vendosmëria fetare, për t’u përballur me sfidat, sado të vështira të jenë ato.

Ndërsa Ambasadori Brownbach, pasi ka vlerësuar tarikatin bektashian në pikëpamje të lirive njerëzore dhe fetare, është ndalur më tej në idenë se shpesh, në kontekste historikë fetar, ka pasur edhe momente të errëta, ku

mekanizma të ndryshëm kanë cënuar rëndë aspektet e lirisë.

Këta momente të errëta, janë përshkuar nga intoleranca, vijoi ai, dhe mua personalisht më vjen shumë mirë kur dëgjoj dhe shikoj konkretisht shembullin tuaj, atë mendim të urtë që çon në shmangie të konflikteve, në përafrim të vlerave më të spikatura të çdo feje apo besimi.

Jam në dijeni gjithashtu të rastit tuaj me “Harabati-Baba” të Tetovës, në Maqedoninë Veriore dhe gjej rastin të përshëndes qëndrimet e Selisë së Shenjtë Bektashiane Botërore.

Ne do të jemi kurdoherë pranë jush, do të punojmë së bashku që liria e besimit të mbetet kurdoherë një shpresë për tejkalimin e çdo realiteti, sado i vështirë të jetë ky.

Koresp. “Urtësia”



// Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj mori pjesë, në konferencën ndërkombëtare “Fetë si instrument për paqen” të organizuar në Tiranë. //

Të bashkuar rreth vlerave njerëzore

Është organizuar në datat 18-19 nëntor 2019 në Tiranë, konferenca “Fetë si instrument për paqen” një bashkëpunim ky i Presidencës së Shqipërisë me Departamentin Amerikan të Shtetit. Idetë dhe fryma e këtij aktiviteti ishin në mbështetje të deklaratës së posaçme për lirinë e fesë, e shpallur prej Sekretarit të Shtetit, Mike Pompeo në verën e këtij viti në Washington D.C në kontekst të gjeopolitikës së sotme kur liria fetare mbetet thelbësore për arritjen e paqes, stabilitetit dhe mardhëniet midis kombeve.

Eventin në fjalë e kanë nderuar me pjesëmarrjen dhe fjalët e tyre personalitete të lartë shtetërore të Ballkanit, lidër të parlamenteve të ndryshëm, lidër të feve në Shqipëri si dhe i ftuari special, Emisari i posaçëm i Presidentit Trump, Shkëlesia e Tij, Ambasadori Sam Brownback.

Në sesionin e parë të konferencës, ishte Presidenti i Shqipërisë Shkëlqesia e Tij Ilir Meta që mori fjalën dhe duke përshëndetur të pranishmit, tha midis të tjerave: “Historia e shoqërisë njerëzore është edhe ajo e besimeve të ndryshme, që kanë qenë forca shtytëse të zhvillimit, shtylla të rrethave shoqërore, baza të moralit dhe vlerave të dinjitetit njerëzor, forca të bashkimit mes popujve dhe kombeve, themele të sigurta të paqes, burim i shpresës për të ardhmen.



Diversiteti fetar është padyshim një nga pasuritë më të mëdha që shoqëria njerëzore ka trashëguar që nga lindja e saj dhe deri më sot. Ndërsa etërit e kombit tonë e konsideruan fenë si një instrument të paqes dhe bashkimit dhe jo si një shkak për luftë, përçarje, apo përjashtim. Për shkak të një rëndësie të tillë në historinë e kombit tonë që ka edhe besimi në zemrën e kombit tonë, gjuha shqipe ka një fjalë të artë që është fjalëbesa, një fjalë unike e cila vështirë se mund të gjejë përkthimin e saktë në çdo gjuhë të botës. Do të thotë “besim” - të vendosësh besimin te njëri-tjetri.

Kjo është një nga fjalët më të rëndësishme në gjuhën shqipe, sepse përfaqëson frymën, shpirtin dhe karakterin e kombit tonë. Besa i shtyu shqiptarët t'i tregonin mbarë botës një shembull të jashtëzakonshëm kurajoje dhe solidariteti në një nga momentet më të errëta të Luftës së Dytë Botërore, kur mbrojtja të gjitha familjet hebreje në Shqipëri. Asnjë hebre i vetëm nuk iu dorëzua pushtuesit në Shqipëri, sepse populli ynë, njerëzit e thjeshtë nga të gjitha besimet bënë gjithçka për të mbrojtur jetët e tyre. Shqipëria ishte i vetmi vend ku në përfundim të Luftës së Dytë Botërore numri i hebrenjve ishte disa



herë më i madh sesa përpara nisjes së saj. Shqiptarët janë ndër popujt që përgjatë gjithë historisë së tyre, nuk kanë njohur asnjëherë luftëra dhe konflikte fetare. Kjo është arsyeja pse harmonia e shkëlqyer, toleranca dhe bashkëjetesa fetare në Shqipëri, të cilën Papa Françesku e quan “vël-lazëri fetare”, janë një shembull dhe frymëzim për mbarë botën.

Të nderuar miq!

Megjithatë, në emër të fesë, historia është e mbushur me momente të errëta të luftërave, gjenocideve dhe shkatërrimit. Fatkeqësisht kjo u dëshmuar edhe gjatë viteve ‘90 në rajonin tonë dhe plagët ende nuk janë mbyllur plotësisht. Ndaj pajtimi i plotë në këtë rajon ka ende rrugë për të bërë dhe ndaj jemi sot përsëri këtu së bashku. Në këtë proces besimi i vërtetë ka një forcë pajtuese të jashtëzakonshme. Për gjysmë shekulli Shqipëria përjetoi një diktaturë ateiste totalitariste më të egra dhe

brutale në botë.

Krerët dhe klerikët e këtyre bashkësive u vranë, u burgosën dhe u martirizuan. Por falë Zotit disa prej tyre arritën t’u mbijetonin burgjeve komuniste, sikurse kemi sot edhe një prej tyre këtu, të nderuarin Kardinalin Ernest Troshani. Ashtu sikurse sot na mungon edhe një prej tyre, At Zef Pllumi, i cili në burgjet komuniste i vendosi vetes vetëm një mision “Rro për me tregue” në mënyrë që të na jepte përmes rrëfimeve të tij më pas në vitet e demokracisë dëshmitë më rrënjëdhënëse të persekutimit dhe martirizimit të klerikëve tanë të paharruar. E drejta për të ndjekur bindjen fetare është themelore për çdo qytetar, por edhe garanci për një shoqëri të begatë, paqësore, demokratike dhe të drejtë. Por, sot fatkeqësisht vetëm 20% e popujve të botës kanë mundësinë ta praktikojnë lirshëm besimin e tyre. Pjesa tjetër e popullsisë botërore është e privuar

nga kjo e drejtë themelore. Ky fakt tragjik shpjegon kërcënimet e sotme nga terrorizmi dhe ekstremizmi. Me dhjetëra të krishterë vriten sot çdo ditë në botë për shkak të besimit të tyre në Krishtin. Shumë bashkësi myslimane janë të diskriminuara ose parajgykohen vetëm nga pamja e tyre e jashtme.

Anti-semitizmi ekziston ende sot. Feja nuk duhet kurrësi të shërbejë për parajgykime. Feja duhet të jetë një instrument për paqen. “Ta falënderojmë Zotin për mundësinë që kemi, gjithë së bashku, sot, për këtë dhuratë të paqes, që na kujton se jemi krijuar pikërisht për ta jetuar këtë paqe,” thoshte Shenjtorja shqiptare Nënë Tereza. Ndërkohë do të doja të kujtoja një njeri mjaft vizionar, kryetarin e parë të Muslimanëve të Shqipërisë pas diktaturës, Hafiz Sabri Koçi, i cili në një përballje me përfaqësuesit e disa shoqatave ekstremiste me ndikime të huaja myslimane në vitin 1994



“**Përgjatë rrjedhave shekullore, historia njerëzore ka dëshmuar veç të tjerave, se në çdo etapë të sajë që nga lindja, ajo ka bashkudhëtuar me besimin pagan apo bestyt, i vërtetë apo jo i tillë, ky besim është përcaktuar prej konteksteve historikë-gjeografikë, duke qenë në çdo rast, në krah të sistemeve apo modeleve moralë dhe shpirtëror të caktuar. Parë si domosdoshmëri ekzistenciale që në krijimin e botës njerëzore, besimi ka pasur e do të ketë vendin e vet të merituar në çdo kohë. Fryma që e ka shtresëzuar këtë dimension njerëzor që në krijimin e njeriut, mbetet pa më të voglin dyshim, ajo e Krijuesit të botëve.**”

iu drejtua atyre: “Unë nuk do t’ju lë juve të shkatërroni vendin tim siç keni shkatërruar vendet tuaja.” Ky është shembulli në mbrojtje të besimit të vërtetë, por edhe të atdheut, edhe të paqes, edhe të bashkëjetesës.

Të gjithë ne kemi detyrime kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, ndaj edhe duhet të angazhohemi më shumë për të luftuar varfërinë dhe për të përmirësuar standardet e jetesës për qytetarët tanë. Është fakt që terrorizmi dhe ekstremizmi fetar lindin kryesisht nga varfëria, kushtet e vështira të jetesës, emigracioni i detyruar ekonomik, mungesa e mundësive, dhe kur shpresa për të ardhmen shuhet nga keq-qeverisja. Qeveritë duhet të krijojnë më shumë vende pune, të sigurojnë arsim të mirë, të hartojnë ligje që promovojnë harmoninë fetare dhe që mbrojnë të

drejtën e lirisë së fesë. Ne po hasemi me një nivel të lartë emigracioni, eksodin e rinisë sonë dhe mungesën e mundësive, si rrjedhojë, duke i bërë vulnerabël komunitete dhe shtresa të caktuara.

“Mos lejoni që Shqipëria të vuajë dimrin demografik të Europës”, na ka porositur Papa Françesku gjatë takimeve me të. Jam, i sigurt se ky nuk është vetëm një fenomen që na ka prekur ne, por të gjithë rajonin tonë dhe duhet ta përballojmë së bashku. Ndaj me këtë rast dua të falënderoj në mënyrë të veçantë Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë, që nuk ka reshtur së apeluar kundër kësaj traume kaq shqetësuese për vendin.

Ndaj ne lutemi që rinia jonë ta ndërtojë këtu të ardhmen dhe bijtë e larguar të shqipes të kthehen në atdheun e tyre për një jetë të mirë

dhe të sigurt. Shqipëria është e angazhuar në procesin e saj të integritimit për anëtarësimin në BE ashtu sikurse edhe vendet e tjera të rajonit. Në veçanti do të doja të falënderoja të gjithë udhëheqësit e besimeve tona fetare, të cilët kanë qenë të bashkuar dhe në mbështetje të plotë ndaj integritimit europian të vendit. Panorama gjeopolitike e rajonit tonë na detyron të bashkohemi në përpjekjet tona për të vetmin projekt dhe aspiratë realiste që kemi të përbashkët dhe që na garanton bashkëjetesën me të gjithë popujt e këtij rajoni e që është integritimi në BE.

Më tej në sesionin e dytë të konferencës kanë shpalosur idetë e tyre rreth perceptimeve dhe sfidave të sotme të fesë liderët shpirtëror shqiptar. Me plot interes u prit në këtë panel edhe fjala e Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve, Hirësisë së Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj i cili tha midis të tjerave: “Është fat dhe krenari që jam i pranishëm në konferencën me temë “Feja si instrument për paqen”, sepse “Feja është mendja, kush s’ka mend s’ka fe” dhe më lejoni t’u sjellë urimet dhe përgëzimet e miliona besimtarëve bektashinj nga Azia në Europë, nga Australia në Shtetet e Bashkuara të Amerikës! Zoti i lartë na ndihmoftë të gjithëve, duke na ndriçuar udhët me dritën e Tij, duke na dhuruar nga dija, urtësia dhe begatia e Tij!

Përgjatë rrjedhave shekullore, historia njerëzore ka dëshmuar veç të tjerave, se në çdo etapë të sajë që nga lindja, ajo ka bashkudhëtuar me besimin pagan apo bestyt, i vërtetë apo jo i tillë, ky besim është përcaktuar prej konteksteve historikë-gjeografikë, duke qenë në çdo rast, në krah të sistemeve apo modeleve moralë dhe shpirtëror të caktuar. Parë si domosdoshmëri ekzistenciale që në krijimin e botës njerëzore, besimi ka pasur e do të ketë vendin e vet të merituar në çdo kohë. Fryma që e ka shtresëzuar këtë dimension njerëzor që në krijimin e njeriut, mbetet pa më të voglin dyshim, ajo e Krijuesit të botëve.

Pa dashur të futem në historinë



fetare, mendoj se çdo njeri, fillimisht ka përqendruar perceptimin e tij rreth kërkimeve mbi botën lindore, duke ndjekur instiktivisht modelet paraardhëse. Por gjatë këtij udhëtimi, duke ardhur në standardet e e habitshëm të zhvillimit të qytetëruar, atij sigurisht i është dashur të manifestojë tiparet e mrekullueshme njerëzore për të zbuluar format e fshehura të dukurive të rëndësishme, sepse është krijesa më e përsosur sa u përket dijeve. Dhe në këto procese evolutive, ka qenë kurdoherë e pranishme ndjenja e devocionit ndaj Krijuesit, e sendërtuar nga një botë jashtlëndore, nga një mesazh pothuaj hyjnor. Në mënyrë të veçantë, në ditët e sotme, përditë e më shumë, gjendet e pambrojtur prej prirjeve sekulariste, indiferencës së globalizmit, venitjes së solidaritetit njerëzor si dhe tentativave që harmonia e mrekullueshme e natyrës të vihet në kontroll të plotë të makinerive teknike, duke mohuar Krijuesin e saj. Fatkeqësisht, feve dhe besimeve u vishen sot, etiketime nga më të ndryshmit, nga më të frikshmit, a thua se janë këta që nxitin luftëra, që shkaktojnë valë dhune dhe terrori, që janë bartës të demonëve, të lindur për të dërguar këtë botë nga njëra luftë vëllavrasëse, në tjetrën.

Paradoksalisht, ndikimi i medias në këtë qerthull të hatashëm të përzi-

erjes së stereotipeve kulturorë dhe identitare, të mesazheve historikë të ardhur prej kryqëzatave, të dramave njerëzore gjoja për shkak të rrugëve të tyre transhendentale ka qenë në kahje të kundërt me sinqeritetin dhe mëshirën substanciale të fesë. Në të vërtetë, nga vetë Krijuesi ynë i Vetëm, nga gjithë librat e shenjtë, nga poetët dhe apostujt e të gjithë kohërave, ne kemi marrë e transmetuar vetëm frymën e shenjtë, arsytet për optimizëm, qëndrimin e denjë përballë çdo njeriu, pavarësisht ngjyrës. Krijuesi i solli ngjyrat për buqetën erëmirë dhe jo për antagonizma të verbër.

Të nderuar të pranishëm!

Besoj se ndajmë të gjithë këtu, mendimin që vëllazëria fetare në Shqipëri ka qenë dhe mbetet një xhevahir i rrallë në kontekstet historikë të Ballkanit dhe më gjerë. Këtë e kemi provuar jo thjeshtë me ato mesazhe të respektit e dashurisë njerëzore të shfaqur në shekuj, por sidomos në standardet shpirtërorë ku atdheu dhe besimi u konsideruan të pandashëm dhe krejt unik në udhëtimin e tyre në kohë. Askush nga oazet e paqes tek ne, as synitë, as katolikët, as të krishterët ortodoks dhe as bektashinjtë, në asnjë moment të bashkëjetesës nuk kemi deklaruar pronësinë ekskluzive të së vërtetës, të

bindur se e vërteta e vetme i takon vetëm Krijuesit dhe Ai, përpara çdo dasie apo mërie ka parapëlqyer unitetin. Në indin kulturor të besimtarëve shqiptar, kjo aksiomë është ngulitur thellë.

Modeli i përkryer fetar i yni, shkëlqeu sidomos në vitet e obskurantizmit më të rëndë, 1967-1990, kur diktatura më e egër e Europës Lindore, bëri ç'është e mundur të zëvendësonte shenjtërinë e Krijuesit, gjoja me shenjtërinë e partisë-shtet, sipas modeleve më antinjerëzore në histori. Edhe në këto kushte, kur qindra klerikë të katër besimeve fetare tradicionale në Shqipëri, u internuan, u burgosën dhe u vranë, besimtarët tanë askurrë nuk e humbën shpresën tek Zoti i Lartë. Janë me qindra shembuj vetëmohimi deri në sakrificë, kur fshehurazi nëpër shkollat e Krujës shpërndahej ashurja e bektashinjeve, nëpër shtëpitë tiranase shpërndahej hallva në netët e mira dhe vezët e ngjyra të krishterëve shpërndahehin anë e kënd vendit në ditët e pashkëve. Ky solidaritet i fshehtë njerëzor, mundi të perceptohej vetëm prej ndjenjave të ngarkuara me dashurinë hyjnore.

Gjej rastin të sjellë në këtë fjalë, shembullin e shkëlqyer të dy Liderve Botërorë të bektashizmit, dede Ahmet Myftarit dhe dede Reshat Bardhit, të cilët u internuan në një teqë të braktisur dhe të rrënuar në fshatin Drizar të Mallakastrës, vetëm e vetëm pse nuk u pajtuan me masat që merrte shteti i kohës, për zhdukjen e fesë. Ata, me devocionin dhe me besimin e palëkundur tek Zoti, e shndërruan teqenë e Drizarit në vendin e prehjes shpirtërore për besimtarët bektashianë jo vetëm nga Shqipëria, por edhe nga Kosova e Maqedonia Veriore. Sakrificat e tyre ka qenë dhe mbetet unike në krejt historinë fetare të Shqipërisë.

Me po atë frymë shenjtërie dhe atdhetarie, të dy këta lider bektashianë, në qerthullin e rreziqeve më të mëdha, vijuan misionin fisnik të mbajtjes gjallë të besimit të Haxhi Bektash Veliut, duke mbajtur gjallë në të vërtetë shpresat e mijëra besimtarëve bektashianë. Ata ditën

të transmetojnë tek armata ilegale e ndjekësve të tyre, jo thjesht substancën, ritet dhe traditat e udhës tonë mistike, por durimin e thellë për të përballuar situatat, shpresën e madhe se “të vërtetat” e sistemeve shkojnë e vijnë, ndërsa E Vërteta e Zotit është e përjetshme. Unë personalisht jam me fat që jam lindur e rritur me frymën e tyre.

Është diçka tjetër që besoj se nuk duhet anashkaluar në këtë auditor. Ndër arsyt kryesore të vëllazërisë sonë fetare,, është padyshim ruajtja e traditës, ndriçimi i saj në mozaikun identitar, pasurimi me elementë të tillë që i shkojnë për shtat epokës që kalojmë. Paraardhësit tanë, por edhe ne udhëheqës e klerikë të sotëm, jemi përpjekur të harmonizojmë brenda kodeve tanë etikë dhe religjionarë shprehjet e jashtme të besimit me pasurinë pafund të traditave , duke ruajtur në mënyrë më të kënaqshme të mundshme, substancën e vlerave historike. Kësisoj mund të themi se ja kemi dalë mbanë edhe kundruall disa prirjeve fetare që na vijnë së jashtmi, por që kjo betejë do të vazhdojë të jetë gjatë, në vorbullën e ngjarjeve në të ardhmen.

Në këtë kontekst, sërish doja të shtoja se një degë e rëndësishme e qëndrimit tradicionalist, është sufizmi, i cili në vetvete sintetizon mesazhin e

Islamit për paqe dhe universalizëm. Me sufizmin, njëri krah i të cilit shkon deri tek Profeti Muhamed, paqja qoftë mbi ‘Të, tradita nuk do të mund të shpërfilllet asnjëherë edhe pas shtresëzimeve të faktorëve jashtëfetarë. Ka shumë teologë të sotëm, të cilët mendojnë se pavarësisht rrugëttimeve të reja që duhen ndërmarrë, sufizmi ka qenë dhe mbetet pasuri e Islamit.

Tarikati bektashian të cilit i përkas, është modeli më i dukshëm i vijimësisë së traditës. Është vullneti i Zotit padyshim, siç janë edhe vizioni e urtësia e klerikëve të djeshëm dhe të sotëm. Por vlen të mos harrojmë se në substancë të këtij besimi, janë përulja shpirtërore, dashuria për tjetrin në krah dhe fryma vëllazërore, pavarësisht të kujt race apo etnie i përket. Prejardhjet teknike apo fetare janë parë prej bektashizmit kurdoherë në këndvështrimin për t’i afruar e bashkuar komunitetet nga Azia deri në Amerikën e sotme. Në më shumë se tetë shekuj të ekzistencës, ne kemi mundur jo thjeshtë të ruajmë identitetin tonë, por përmes tij të japim mesazhin e madh: dashuri për të gjithë! Është kjo arsyeja që çdo ditë e më shumë pushtojmë territore të rinj shpirtërorë.

Së fundi, ajo që mendoj të inkurajojmë së bashku, ideja që në hallet dhe brengat pafund të shfaqura në qytetërimin e sotëm, sa herë që ulemi nëpër

tryeza gjeo-politike për kapërcimin e krizave, ne duhet të thërrasim për ndihmë Zotin. Sepse, sado e mrekullueshme që të jetë makineria e mistereve financiare, sado mëndjehapur të jetë një politikan në Lindje apo tjetri në Perëndim, sado kalkulime të sakta të kemi rreth pasurive të kësaj bote në tokë e nën ‘të, askurrë nuk do ja dalim dot, pa besimin e palëkundur në Zot. Imam Aliu, njëri prej udhëheqësve kryesorë të tarikateve të Islamit, ka thënë shprehimisht: “Zoti nuk u ndau robve të Tij, diçka që të çmohej më shumë se inteligjenca.” Duke mësuar për Zotin e Lartë, nxjerrim në pah inteligjencën në funksion të paqes e mirësisë në gjithë botën. Ju faleminderit të gjithëve! “

Në seancat e tjera në konferencë, u theksua se feja, ka ndikuar, për zhvillim dhe ecjen e shoqërisë. Roli kozmik, përmes Zotit absolut, besimi tek qënia njerëzore, ka krijuar vlera dhe ndjesi, për ecjen përpara, të shoqërisë. Rëndësi ka, që këto vlera dhe besimi, të udhëhiqen nga realitete, që çojnë, jo drejt regresit por progresit, që ka si përmbajtje, ripërtëritjen shpirtërore dhe ndërjegjeshmërinë, për shpëtimin nga rreziqet e botëkuptimit të errësirës, të egocentrizmit, të mos ekulibrave të ndryshëm, mendimin e qënies njerëzore, shoqërore.

Koresp. “Urtësia”



// Piktori i shquar europian Omer Kaleshi, i dhuron Selisë së Shenjtë Bektashiane, //
një fond të çmuar të veprave të tij

Atdheu im i vetëm



Kur në majin e vitit 2016, së bashku me Kryegjyshin Botëror Bektashian, Hirësinë e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj shkuam për të parën herë në atelien e tij, mu duk sikur ishim përpara një peizazhi baritor të trishtë, në gjoks të maleve. Pastaj na u shfaqën dervishët bektashinj dhe çuditshëm pyeta veten se si këto tablo plot kolorit, imazhe të një jete të përkorë, rrinë këtu pranë njëra-tjetrës, poshtë lumit njerëzor që gurgullon pa u ndalur askurrë, në bulevardin e njohur parisien: Arago? Por pashë edhe diçka të çuditshme, nuance një gëzimi të beftë, brenda syve të piktorit të madh. Gëzimi i shoqëruar edhe me një shprehje bujare: “Po, do u dhuroj disa barinj e dervish. Do ndihen më mirë se kudo, tek ju, në Tiranë!”

Sot, në fund të nëntorit 2019, kur fjalët u kthyen në realitet, kur galeria me tablot e dhuruara aq bujarisht prej piktorit Omer Kaleshi, u rrethua mrekullisht prej stendave, objekteve dhe vetë historisë 800 vjeçare të bektashizmit, më vete mendja tek një përcaktim që Ismail Kadare, ka nënvizuar vite më parë: Pikturat e Omer Kaleshit janë në kërkim të harmonisë universale! Për ta shtjelluar më tej me një ide interesante të autorit të shquar francez Lacarrier, i cili në mbrëmjen e 16 dhjetorit të vitit 2002, ndërsa tablotë e dervishëve ekspozoheshin në “Sallën e hapave të humbur” në UNESCO, u shpreh tekstualisht: “Nuk ka artist që shkon drejt universale pa u nisur nga diku. Duhet të kesh lindur diku, për t’u nisur gjetkë. Them kështu gjithnjë, sepse një lum, që do të mo-

honte burimin e vet, nuk do të mbërrinte kurrë në det. Këtë e thotë piktura e Kaleshit. Është një pikturë që mund të konsiderohet se ka lindur diku. Ajo ka një vend, një atdhe që ngjanë me mozaikun

e një prej piktorëve më të mëdhenj shqiptarë në këta dy shekuj të fundit. Është kënaqësi gjithashtu që ai iu përgjigj ftesë sonë dhe erdhi posaçërisht nga Parisi për të ndarë së bashku emocionet e kësaj dite. Ju faleminderit nga zemra profesor Omer Kaleshi dhe ju siguroj

shtesë në objektin tonë shumëdimensional, por një vlerë më shumë, një dritë më shumë në mozaikun e trashëgimisë sonë të kulturës bektashiane universale. Sinqerisht, do të kisha dëshirë sot, të dëgjoja miqtë më të ngushtë, ambasadorët apo piktorët, të flisnin për veprën



e fëmijërisë së tij, adoleshencës, midis Maqedonisë, Shqipërisë dhe Turqisë. Këto botë janë aty, por njëkohësisht ato shkojnë shumë larg. Nëse këto figura janë kaq të forta, ato janë se në një moment barinjte dhe dervishët e lënë pas token e Anadollit, për të qenë diku mes dhimbjes dhe parajsës...”

Në ceremoninë e përrurimit të galerisë, ka përshëndetur Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj: “...Është kënaqësi e veçantë të jemi sot së bashku në promovimin e galerisë që mbanë emrin

se do të keni kurdoherë urimet më të mira të gjithë bektashianëve, kudo ku ata jetojnë e punojnë nëpër botë! Galeria e sotme, ka ardhur në momentin e duhur dhe përpara se të jetë vullneti ynë, i njerëzve, është padyshim vullneti i Zotit. Tanimë, identitetit tonë të materializuar në muze, historisë, etnografisë, trashëgimisë kulturore kaq të pasur, do t'i shtohet edhe galeria me emrin e vëllait tonë Omer Kaleshi, arti i të cilit prej dekadash është bërë i njohur në gjithë Europën dhe vështrohet nga miliona dashamirës të pikturës. Nuk kam as më të voglin dyshim, se kjo galeri e mrekullueshme, nuk është thjeshtë një

e Omer Kaleshit. Por më jepet e drejta sigurisht të them, se jeta njerëzore dhe ajo artistike bashkudhëtojnë në karakterin e Omer Kaleshit në një harmoni të habitshme. Personalisht ruaj mbresa të jashtëzakonshme të takimeve me ‘të si në Paris, në ditët bektashiane për nder të Naim Frashërit, ashtu dhe në Tiranë, si miku i Selisë tonë të Shenjtë. Thjeshtësia dhe urtësia që rrethojnë këtë personaliteti, më kujton shpesh dervishët dhe baballarët tanë, të cilët në teqetë më të largëta, në vetminë e tyre kanë shpërndarë dashuri hyjnore edhe përmes heshtjes së tyre. Është pak të them se dita e sotme është histor-



ike për bektashinjtë në mbarë botën. Portretet e dala prej shpirtit të Omer Kaleshit, që në të shumtën e rasteve janë vegime dervishësh bektashianë, i



shtojnë një dimension të ri, jo thjeshtë këtij muzeu, por vetë historisë sonë, të sotme dhe të nesërme. Ato do të mbeten këtu përjetësisht, falë gjestit bujar të vëllait tonë Omer Kaleshit, i cili e ka taksur këtë dhuratë gati një vit më parë, kur bisedonim në shtëpinë e tij, në Paris. Ajo bisedë e vjetshme sot është shndërruar në një realitet kaq mbresëlënës. Edhe një herë faleminderit vëllai ynë Omer Kaleshi! Zoti të ruajt dhe të paçim sa malet!...”

Më tej, personalitete të shquar shqiptarë, kanë dashur të hedhin penelata të shpejta mbi veprën e piktorit të njohur. Besnik Mustafaj u ka kujtuar të gjithëve se ky akt i sotëm, do rezonojë gjatë jo

thjeshtë në kujtesën bektashiane, por edhe në hierarkinë e vlerave të yvera të traditës dhe modernes së Tiranës. Moikom Zeqo, e cilësoi gjenialitetin e tablove të Kaleshit me piktorët botëror të shekullit që jetojmë. Prefektja e Qarkut të Tiranës, Suzana Jahollari, tha se ndjehej e mahnitur përballë këtij arti, ndërsa akademiku nga Maqedonia Perëndimore Aziz Pollozhani, analizoi një temë të gjerë dhe unike, duke ndriçuar vetëm një kahje të tablove. Suzana Mehmeti u rrek të tregojë se në madhështinë e thjeshtësisë së tij, gjithçka ishte transparente, e tejdukshme, gati e përjetshme. Ndërsa Luan Rama,

do të thoshte: Omeri më ka treguar se banorët e fshatit të tij të lindjes, ishin të gjithë të fesë myslimane. Shumica e fshatrave fqinj ishin më së shumti kozmopolitë, gjysma shqiptarë dhe pjesa tjetër e krishterë, pra sa myslimanë edhe të krishterë. Një xhami në krah të një kisha... Kujtimet për Omerin janë të shtrenjta. Janë prehje, janë imazhe, vende malli dhe rikthimi që sa vijnë e rishfaqen gjithnjë e më shumë, bëhen më ët pranishme në mënyrë kryeneçe, me këmbënguljen për të mos u harruar, për të mos u shuar...

Pas fjalëve të dala zemre, zbulohet busti i Omer Kaleshit, realizuar mjeshtërisht prej skulptorit të shquar

Muntaz Dhrami dhe më tej vështrimet i drejtohen galerisë. Këtu shfaqet përmes një heshtje solemne akti i madh, ku veçanërisht ngjyrat, e kuqja dhe e zeza që dominojnë, na kujtojnë të gjithëve dramën ballkanike, ku vdekja e përgjakur thirrej jo rrallë prej mërive të verbra religjioze apo etnike. Ndërsa ngjyra e bardhë e tejdukshme, më duket se zhvendoset heshturazi nga njëra tablo në tjetrën, njëlloj si mjegulla që do të fshehë apo të nxjerrë në pah më thellë, bukurinë e peizazheve. Janë artistë dhe kritikë arti, ambasadorë dhe intelektualë që përshëndesin me vështrim Omer Kaleshin, duke kërkuar shpesh të fiksojnë në celularët e tyre, çaste emocionuese.

Vizita nëpër galeri krijon ndjesi të veçantë. Një linjë okër ndan hapësirën e bardhë. Një linjë imagjinare ku mbështetet një kokë njeriu. Botë njerëzore të nderura, symbyllura, të trishtuara, që kërkojnë shpeshherë të dialogojnë me vizitorin që kanë përballë. Gjithnjë sfonde të bardhë të ndarë si me thikë përmes, ku mungojnë sfondet e zakonshme të kuq apo të zezë. Të ngjan se je i rrethuar nga dëborë, i tërhequr njëkohësisht nga ata portrete të ardhur s’dihet nga ç’botë mistike. Luan Rama më thotë, se dervishët e Omer Kaleshit janë disi të ngjashëm, hijerëndë, burrërorë, sikur në supet e tyre të mbajnë shkëmbinj të mëdhenj, halle. Megjithatë secili është një botë më vete. Një jetë, një histori. Një dhimbje e heshtur, e mpiksur.

Në vështrimin e tyre disi të mjegullt, ata qëndrojnë gjithnjë në këmbë, të lodhur si duket nga ai rrugëtim i gjatë përmes fushash pa anë, shkretëtirash të djegura nën një diell përvëlues. Hijerëndë tek mërmërisin këngë të vjetra sa bota.

Herë me kapuçë të kuq, herë krahëhapur, herë të mbytur në trisht e në dhimbje, ata janë gjithnjë aty, në tablotë e studios së tij apo në ekspozita, gjithnjë diku... Gjithnjë të paqtë, të mirë, me sy të perënduar. Ata mund të jenë dhe Jonuz Emre, dhe Haxhi Bektash apo Ibu Ata Allah... njerëz që vijnë nga



errësira në dritë, sufistë që thonë: „Edhe në errësirën më të madhe, fytyra tënde më jep dritë“.

Në tablotë e Omerit, dervishët, herë burra, herë adoleshentë apo gra, mërmërisin pambarimisht lutje, që prej njëmijë vjetësh. Nën gunat e tyre të zeza e të bardha, herë hijerëndë përballë resh e stuhish, e herë ëndërrues e të ngazëllyer si në prag pranvere, barinj të Omerit janë krijesa të pafjalta. Në buzët e tyre duket se është mpiksuar një mërmërimë e vjetër mitike. Njëri pas tjetrit, krijuar në stinë e kohëra të ndryshme, ata të shfaqen pareshtur, si të vijnë nga larg, në të njëjtin hap e udhë, si nga kohëra antike. Vijnë ata nga fushnajat e pamata të Anadollit, nga kodrinat e harruara të Kërçovës, apo nga malet e hirta të veriut shqiptar.

Herë-herë, sytë e tyre janë mbuluar nga një cohë apo një llohë dëbore. Herë-herë të ngajnë me bij të shtrëngatës, apo të paqtë dhe dehës, nën një qiell të murrmë. Dhe pse hijerëndë, ata të dhurojnë në një mënyrë bujare e memece, një dashuri e miqësi sublime. Pse vallë Lacarriere i kishte quajtur ata “princër të hapësirave të mëdha”

*Ti princ i hapësirave të mëdha, udhëtar i pafundësive,
në teqenë e këngëve ke ndalur më në fund,
atje ku natën tjerë, me fillin e lutjeve,
që dita të lindë, në buzët e dritës.“*

Me kujtimet e tij për vendlindjen, me arsimimin në lagjen e shqiptarëve në Stamboll, me vizitat e herë pas hershme në trojet e tjera shqiptare, me fisnikërinë e jetës pariziene në më shumë se gjashtë dekada, Omer Kaleshi të shëmbëllen me një enciklopedi malli të vazhdueshëm. Ndonëse udhëton dhe mediton gjatë, ai kapërcen lumenjtë e retrospektivës duke deklaruar pak kohë më parë: “Bota ime gjendet në atelienë time. Këtu janë bashkuar lindja dhe perëndimi, veriu dhe jugu, prej këtu e nisin rrugëtimin pikturat-koka në të katër anët e botës, udhëtojnë me fatin e tyre. Unë nuk jam nisur kurrë nga koncepte apriori, ata ndoshta janë zgjuar në aktin final, kur pikturat kanë përfunduar. Pikturat e mia janë vazhdimi dhe zgjerimi i jetës sime, janë atdheu im i vetëm.”

Syrja Xhelaj
21 nëntor 2019





Solidaritët dhe humanizëm njerëzor

Qysh në orët e para të mëngjezit, të tërmetit të datës 26 nëntorit, Kryegjyshata Botërore Bektashiane me Seli në Tiranë jetoi minutat e humbjeve të mëdha njerëzore. Kryegjyshi, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj dërgoi mesazhin për të prekurit nga tërmeti dhe ngushëllime për familjet e viktimave. Të dashur miq! Po ndjekim me shqetësimin e natyrshëm njerëzor ngjarjet e shkaktuara nga tërmeti i disa orëve më parë, dhe në mënyrë të veçantë, dëmet në Durrës, Thumanë dhe Krujë. Jemi pranë dhimbjes së familjarëve të viktimave duke ndarë së bashku pikëllimin e thellë, sikundër japim forcë dhe kurajë shpirtërore për të lënduarit e shumtë fizikisht. Ngjarje të tilla të pa parashikuara natyrore, na bëjnë të jemi sa më pranë njeri-tjetrit dhe i lutemi Zotit të Lartë të na japë forcë e vullnet, t'i kapërcejmë sa më butë këto situata.

Zoti e bekoftë Shqipërinë! Amin!

Ndihmat e Kryegjyshit Botëror Bektashiane në ditët e para pas tërmetit për tu ardhur në ndihmë të prekurve nga kjo fatëkeqësi konsistuan në ushqime, sheqer, oris, makarona, vaj, krip dhe mish. Këto u çuan

në qendrën e grumbullimit të caktuar nga Bashkia e Tiranës. Kryegjyshi Botëror vizitoi familjet e prekura nga tërmeti më gjashtë dhjetor në çadrat e ngritura për të pastrehët, në Thumanë, ku ka takuar familjet që janë akomoduar për të qenë më të sigurtë. Ai bëri thirrje për më shumë dashuri, paqe, miqësi e solidaritet vëllazëror, më shumë adhurim e shpresë tek Zoti, që të na japë më shumë forca e energji për të përballuar dhimbjen që ka pushtuar në gjithë shqiptarët dhe miqtë tanë në gjithë botën. Duke filluar që pas momenteve të para të goditjes sizmike, Selia e Shenjtë Bektashiane ka qenë e do të jetë çdo çast pranë të dëmtuarve, me dashurinë vëllazërore e ndihma, në ushqime e veshmbathje. Gjithashtu Kryegjyshi ngushëlloj gjithë familjarët që humbën njerëzit e tyre në këtë tragjedi të rëndë, si dhe bekoj miqtë e ardhur me ndihma e solidaritet për të shpëtuar e ndihmuar njerëzit në rrënoja. Në fund ai tha: "Duke qenë kështu të gjithë së bashku, të bëjmë sa mundemi për të minimizuar pasojat dhe kthimin e normalitetit në shpirttrat tanë dhe vendin ku jetojmë".

Sigurisht disa dëme nga tërmeti pati edhe teqeja e

Dollmës në kalanë e Krujës, si: çarje e derës kryesore, dritaret e dëmtuara, çarje muresh,shkëputje fragmenti të afreskut etj. Historia e saj është e vjetër. Nodhet brenda Kalasë së Krujës në perëndim të saj. Ndërtuar në shekullin e XV-të.Rindërtuar duke ruajtur edhe ambientet e mëparshme, në vitin 1778 - 1779. Rindërtimi dhe ripikturimi të gjithë sipërfaqes së saj është bërë nga Adem Aga Toptani dhe konakun për pushim, ngrënie dhe pirje. Në oborrin e teqesë ka pasur 9 varre dhe një ulli sipas specialistëve është para vitit 1500,tregojnë se në hijen e tij rrinte Skënderbeu. Rruga kryesore e hyrjes ka qenë urë me hark e prishur në vitin 1917 dhe 1970, e rindërtuar së fundi pas viteve 1990. Janë dy varret e Haxhi Mustafait dhe Hyxhet Babait e të tjerë të mëvonshëm.Teknika e ndërtimit është ajo me gur të rrumbullakët,të lidhur me llaç gëlqere.Fasada kryesore, është ndërtuar me gurë të skuadruar,të vendosur në rreshta jo të rregullt. Dera e hyrjes dhe dy dritaret anash kornizohen nga bordura vertikale prej guri në formë konkave, të trajtuara në harmoni me konceptin monumental të teqesë. Interieri ndriçohet nga dymbëdhjetë dritare. Ka fragmente mbishkrimi që lexohet data e rindërtimit. Ka një kompozim vëllimor tipik në sistemin me tambur poligonal dhe kupolë sferike mbi trompa anësore.Përmban vlera artistike të pikturës murale në teknikën e afreskut.Sipas mbishkrimeve, tyrbja është dekoruar në dy kohë të ndryshme,që vërtetohet

edhe nga veçoritë stilistike të seicilit prej mjeshtërve piktorë. Për këto vlera teqeja e Dollmës është monument kulture. Një trashëgimi e tillë kulturore, ka bërë që ky objekt i tarikatit bektashian, të vizitohet në këta vite nga mijëra njerëz, jo thjesht vizitorë turistik, por edhe studiues të huaj,të mrekulluar pas strukturave të ndërtimeve bektashiane.

Menjëherë pas tërmetit, ispektuan gjëndjen e saj nga Gjyshata Bektashiane e Krujës, Kryegjyshata Botërore dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës me drejtorin e trashëgimisë kulturore, z. Arben Spaho. Duke parë gjëndjen në vend dhe u përgatit raport i dëmtimeve. Kryegjyshi Botëror, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj e pa nga afër gjëndjen e teqesë dhe dha porosi personelit dhe besimtarëve të Krujës të jenë të kujdesshëm dhe ritualet t'i bëjnë në teqetë e tjera të Krujës, deri sa të bëhet restaurimi i plotë i saj.

Pasojat e tërmetit të 26 nëntorit janë ndjerë edhe në Selinë e Kryegjyshit Botërore në Tiranë. Për të inspektuar dëmtimet dhe për testuar sigurinë e ndërtesës ka mbërritur në Selinë e Kryegjyshit pasditen e së dielës, 8 dhjetor, një grup ushtarakësh izraelitë të shoqëruar edhe nga Kryerabini, z.Yoel në Shqipëri. Pasi pane nga afër ndërtesën shumë dimensionale të Selisë, ekspertët ushtarakë thanë se dëmtimet janë sipërfaqësore, ndërsa godina është e sigurt dhe mund të përdoret nga besimtarët pa problem për të





kryer ritet e tyre të besimit. «Është një ndërtesë e jashtëzakonshme, ka një stabilitet. Gjithçka është e sigurt». Nga ana e tij, Kryegjyshi ka falenderuar ekspertët izraelitë, shtetin izraelit për ndihmën që u dha shqiptarëve në këto momente, ndërsa u ka kërkuar gjithashtu që të inspektojnë edhe selinë në Krujë, e cila ka pësuar dëmtime më të rënda. Ndërsa, ekspertët nga Izraeli thanë se populli shqiptar ka ndihmuar popullin hebre në momente të vështira të holokaustit dhe ndaj e kanë detyrë ndihmesën. Eksperti izraelit u shpreh: “Gjysha ime ka qenë e prekur nga genocidi dhe holokausti. Ua kam borxh jetën njerëzve dhe ju që na keni mbrojtur. Ne si fe na bashkon mirësia e Zotit dhe duam të mirën e gjithë njerëzimit. Më pas ushtarakët dhe Kryerabini kanë vizituar edhe Muzeun e Kryegjyshit Bektashian, ku janë njohur me historinë e bektashizmit në Shqipëri dhe në botë.

Koresp. “Urtësia”

“ Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonise

Çmoj atdhe

Një bisedë gati vëllazërore midis miqsh të vjetër, është zhvilluar më 5 dhjetor 2019 në 2 Shkup, në mjediset e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë Veriore, në prani të Kryetarit, Shkëlqesisë së Tij, Telat Xhaferri dhe Kryegjyshit Botëror Bektashian, Hirësisë së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimajt. Duke marrë shkas edhe nga zhvillimet më të fundit politike në rajon, veçanërisht aspiratës shqiptare për t’u integruar në familjen europiane, biseda është përcjellë në kontekstet kohorë të ndërthurur me perceptimet dhe vizionet fetare në këtë aspekt. Është fare e dukshme, u tha aty, se ndër vlerat e spikatura të shqiptarëve, kudo ku ata jetojnë në Ballkan, mbetet padyshim toleranca fetare, përkujdesja e liderëve të komuniteteve të besimtarëve, për të respektuar jo thjeshtë njeri-tjetrin, por substancën e lirisë dhe ushtrimit të besimit tek Krijuesi.

Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, nga ana e tij, e njohu Kryeparlamentarin Xhaferri me nismat më të fundit të Selisë së Shenjtë Bektashiane, në kuptimin e shpërndarjes së asaj fryme dinjiteti e përulje të thellë shpirtërore, jo thjeshtë në komunitete besimtarësh, por edhe në mbarë shoqërinë njerëzore. Bektashinjtë kanë ditur gjithmonë të shfaqin tolerancën dhe vëllazërinë e tyre fetare, jo me fjalë e konferenca, por me qëndrime konkrete, duke dëshmuar së



donisë së Veriut: Mirënjohje për Kryegjyshin Botëror Bektashian //

atdashedashurinë tuaj

pari devocionin e tyre ndaj Krijuesit dhe më tej, prej këtij devocioni edhe bashkëjetesën e mrekullueshme me të tjerët, të etnisë, ngjyrës apo besimit jo të njëjtë. Në disa prej ngjarjeve më kulmore të historisë shqiptare, sidomos në shekullin e njëzetë, bektashinjtë janë shndërruar në promotorë të bashkimit të shqiptarëve për t'u dalë zot fateve të kombit.

Duke falënderuar më tej Kryeparlamentarin Xhaferri për nderin e madh, Kryegjyshi Botëror vijoi: "Sigurisht, një traditë e trashëguar nga brezat paraardhës, përbën në çdo kohë krenari të ligjshme për të gjithë. Por kjo nuk do të thotë aspak se kjo traditë nuk mund të çenohet prej shkaqeve të ndryshëm, aq më tepër në kohërat plot prirje sekulariste që jetojmë. Prandaj ne bektashinjtë vazhdojmë të pasurojmë të kaluarën tonë qoftë historike, qoftë doktrimore me prurje të reja, duke dëshmuar në çdo situatë dashurinë për mos t'i asnjëherë dashurinë e Zotit me fatet e kombit. Ne kemi qenë dhe mbetemi në radhët e para të atyre që traditën e pasurojnë duke 'shkrirë' pasuritë doktrimore me realitetet e sotme, duke dashur të mbrojmë sa më shumë besimtarin prej gjërave të vdekshme të kësaj bote. Gjej rastin sot, t'ju themë se



nderi që më bëhet në këtë ceremoni, u shkon edhe vëllezërve të mijë, klerikëve bektashianë anë e kënd botës, që jetën e tyre e kanë vënë plotësisht në shërbim të besimtarëve, për të përçarur tek këta shpirtin e tolerancës së Haxhi Bektash Veliut."

Në fund të bisedës, në prani të stafit të tij, Kryeparlamentari Xhaferri, i dorëzoi Kryegjyshit Botëror, 'Mirënjohje' me motivacionin: "Në shenjë vlerësimi për kontributin e dhënë për forcimin dhe konsolidimin e besimit tek Zoti. Propagandimin e promovimin ndërkombëtar të vlerave liberale universale, të vërtetës, diturisë, të drejtës, ligjit, sinqeritetit

e emancipimit shoqëror në mbarë njerëzimin. Për lartësimin e paqes dhe harmonisë, tolerancës fetare, ndëretnike, dashurinë e solidaritetin njerëzor, duke ruajtur dhe mbajtur lart dashurinë për atdheun. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Kryetari Telat Xhaferri, ju falënderon dhe vlerëson lart misionin tuaj fisnik."

-Në vijimësi kam çmuar dhe çmoj atdashedashurinë tuaj dhe jam i bindur se bektashizmi do të luaj rolin e tij të shkëlqyer në kuadër të vëllazërisë tonë fetare-tha në fund të takimit Kryeparlamentari Xhaferri.

Koresp. "Urtësia"

Dritë prej “Kurorës së Malit”

Nga Mirjan Aliaj

Jam rritur me imazhin e teqesë së Golimbasis. Kam qenë gati shtatë vjeç kur shkova për të parën herë në rrënojat e asaj teqeje. Më mori përdore gjyshja ime, Merfaja dhe më porositi se po të na pyesnin udhës, do u thoshim se shkojmë për dru zjarri.

Unë isha kureshtar të dija diçka për baba Bektashin. E dija se gjyshja ime e kish pasur vëllanë e babait të saj, ndaj e pyesja. Ajo plakë e urtë dhe fisnike, shikonte përreth e frikësuar dhe me zërin që dukej se i vinte nga një humbëtirë, më rrëfente për bëmat e baba Bektashit.

Dikur, mbaj mend se ja shkëputa dorën time nga e saja dhe e pyeta: “Nëno, po të ishte gjallë baba Bektashi, çfarë porosie do më jepte mua?”

Ajo u mendua pak dhe foli: “Me siguri do të thoshte të mësoje shkollë sa më mirë!”

Kur shkuam në rrënojat e teqesë po binte muzgu. Gjyshja ime nxori nga gjoksi një copë gazete ku pati mbështjellë një llokume, e hapi dhe ma dha ta haja. Pastaj po nga gjoksi nxori dy-tri qirinj dhe i vuri pranë një guri të madh, të nxirë nga flakët. Me sa duket, aty shkonin të gjithë e ndiznin qirinj. Pastaj dëgjova gjyshen që po fliste me vete. Dola nga përpara të dëgjoja më mirë, po ajo me dy pëllëmbët e hapura pranë gjoksit, diçka pëshpëriste. S’munda të kuptoj asgjë.

Por, instinktivisht edhe nuk ja ndala atë pëshpërimë dhe diçka i pëshpëriti sërish baba Bektashit. Edhe unë instinktivisht i vura dy pëllëmbët e mija përpara gjoksit, pa ditur ç’të thosha.

Kështu ndenjëm për tri-katër minuta, pastaj gjyshja më mori për dore në rrugën e kthimit. Morëm disa kërcunj të vjetër në krah dhe vonë në mbrëmje ishim në shtëpi.

Vëllai im më i madh, Krenari, më përqafoi dhe m’i nguli sytë i qeshur. “Ç’tosh baba Bektashi” më pyeti gati fshehurazi. Por unë s’ju përgjigja. Më vonë, Krenari më tregoi se kish shkuar me qindra herë i vetëm në Golimbasis për të ndezur qirinjtë që i jepte gjyshe Merfaja. Dy javë më pas unë nisa klasën e parë dhe rrija tërë sy e veshë përballë mësueses, aty në bankën e parë, duke dashur të përmbushja porosinë e baba Bektashit.

Ndonjëherë, kur ishin pushimet e verës, unë e Krenari shkonim vetë, pa u thënë atyre të shtëpisë, blinim qirinj në dyqanin e fshatit, i fshinim ata në xhepa dhe drejt e në teqenë e rrënuar. Na dukej se dikur do na vinte të na takonte baba Bektashi, kur ta shihte se sa shumë të vendosur ishim ne, në udhën e Zotit. Kjo nuk ndodhi, sidoqoftë unë dhe Krenari ja dimë për nder baba Bektashit se ishim ndër nxënësit më të mirë në klasat tona.

Këtu, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kam ardhur në vitin 2002. Kërkova vetë të vija në Detroit, për shkak të teqesë bektashiane. Vetëm dy ditë kisha në Detroit dhe ja mbatha në teqe. Më patën folur në Sevaster për baba Arshiu dhe nuk më zinin këmbët dhe pa e takuar. Ishte behar dhe baba Arshiu kish dalë përjashta dhe me një ashkël druri, rrëmonte dheun e vazove me lule. E takova sipas zakonit bektashian dhe pashë se i qeshën ata sytë jeshil dhe të mëdhenj.



Për t'ja bërë qejfin akoma më shumë i tregova emrin, mbiemrin, i thashë se kisha lindur në Sevaster dhe isha nipi i Shero Jeminit. E dija që në vitet 1940-1944, Shero Jemini dhe dervish Arshiu ishin vëllezër për kokë dhe qenë simpatizantë të flaktë të Ballit Kombëtar. Baba Arshiu më mbështeti supin në krahun tim dhe duke lotuar mundi vetëm të thoshte: "Ah ç'burra patë nxjerrë moj Vlora mavria!"

Ky ka qenë takimi im i parë me baba Arshiu. Atë natë m'u lut të rrija në teqe dhe donte t'i tregoja për Sevasterin, për njerëzit, për teqenë, për vendin e shenjtë në "Kurorën e Malit". Dhe unë nuk ja prisha qejfin. Hëngrëm darkë shpejt e shpejt dhe u ngjitëm sërish lart në odën e pritjes. Unë flisja dhe ai nuk m'i ndante sytë. Kur unë heshtja pakëz, gjente rastin dhe më pyeste: "Po ata rrapet poshtë në çairet e Sevasterit, janë? Po ata ujët e ftohtë midis rrapeve janë, apo ja kanë marrë frymën nëpër kanale. Po tek "Kurora e Malit" ka çuar njeri baba Reshati apo e kanë lënë ashtu në dorë të Zotit?" Unë i përgjigjesha me aq sa dija dhe shihja se si sytë e baba Arshiut herë trishtoheshin dhe herë ngazëlleshin.

Dikur, në heshtje, më shumë për t'i bërë qejfin unë u çova dhe vajta pranë portretit të baba Rexhebit, të varur mbi oxhakun e dhomës. Baba Arshiu më ndoqi me sy dhe kur unë u ktheva të ulesha më tha: "Çdo fjalë e tij ishte një këshillë për ne!" Pastaj unë prita që ai të fliste dhe mos të ndalej për myrshidin, por në të vërtetë babai heshti. Më vonë, duke lexuar tekste mbi mistikën, më ka bërë përshtypje që ndër cilësitë e mrekullueshme që e rrethonin Profetin Muhamed (paqja qoftë mbi Të) sipas të cilës Ky nuk bisedonte për çështje të ndryshme dhe të shumta, por vetëm për ato gjëra që mund të sillnin mirësi në ymetin mysliman. Ndërsa miqtë dhe ndjekësit e tij, e dëgjonin me aq vëmendje, sa edhe ndonjë zog t'u qëndronte mbi supe, ato nuk e trembnin.

Këta e konsideronin guxim të madh

të pyesnin Profetin tonë për çështje të ndryshme, ndaj edhe prisnin me padurim të vinte ndonjë beduin nga shkretëtira, ta pyeste Atë dhe të tjerët të dëgjonin përgjigjet. Dhe dihej që brenda çdo përgjigjeje ishte urtësia dhe dashuria për njerëzit. Mbahet mend që Ebu Hurejre të kishte thënë midis të tjerave se gjatë një lufte, ne i lutëm Profetin të mallkonte qafirët, të cilët po na dobësonin radhët.

Profeti i menduar u qe përgjigjur ndjekësve të tij se: "Unë nuk jam dërguar për mallkim, por për mëshirë për botët." Pas asaj nate që fjeta në teqe, u ndjeva shumë më afër Shqipërisë dhe Sevasterit. Sepse pavarësisht se këtu është Amerikë, sado midis bollëkut të jesh, mallin e vendlindjes nuk ta zëvendëson dot askush. Edhe më tej Amerikës po të vete, udhët, rrapet, ujërat e Sevasterit unë jo vetëm që si harroj, por më duket se më ndjekin nga pas si manarët nënën e tyre.

Një ditë, pas Sulltan Novruzit të vitit 2004, kur shkova sërish në teqe, baba Arshiu po çlodhej në kolltukun e tij duke rrotulluar tespjet në duar dhe duke kënduar me zë të ulët një këngë labe të vjetër. M'u duk momenti më i përshtatshëm t'i sillja ndërmend të shkuarën dhe duke i ngulur sytë tek sytë e tij, e pyeta papritmas: "Si e mban mend Shero Jemini?" "Ah Shero lumëmadhi" pëshpëriti baba Arshiu dhe më tregoi se si në dimrin e egër të vitit 1940, ky kish shkuar disa ditë në teqenë e Golimbasit, sepse në Vlorë, Italianët e kishin vënë në shënjestër për ta vrrarë.

Vetëm dy ditë kish Sherua në teqe, kur erdhi një myhib nga Sevasteri dhe i tha baba Bektashit se 60-70 italianë ishin nisur për në Golimbas. Që të vinin në Golimbas kaq italianë të kapnin Shero Jemini, do të thoshte se ky trim nuk ishte njeri dosido, pavarësisht se pamja e tij e parë ashtu ta jepte përshtypjen.

Baba Bektashi një lajmërim të shpejtë bëri dhe në teqe brenda orës u mblodhën 40-50 burra me pushkë. Kaq duheshin. Nga frika se mos italianët digjinin teqenë Shero Jemini me

trimat e tjerë u ngjitën rreth 700-800 metra më sipër dhe zunë pozicionet. Por italianët nuk shkuan dot në Golimbas se në të dalë të Vlorës i kish bërë pusi çeta e Hysni Lepenicës. Nga ai moment Shero Jemini nuk ju nda nacionalizmit të kulluar shqiptar.

Në marsin e vitit 2012, përpara se të nisesha për në Sevaster, të çmallesha me prindërit dhe të afërmit e mi, shkova në teqe tek baba Arshiu. I thashë se do nisesha për në Shqipëri dhe ai u çel. "Lumthi ti" mundi të thoshte dhe më përqafoi. Pastaj më porositi të shkoja në teqenë e Golimbasit, në "Kurorën e Malit", në Koshtan, në teqenë e Zallit dhe së fundmi në Tiranë.

Unë kisha vetëm dhjetë ditë pushimi dhe m'u qesh kur babai më jepte tërë ato detyra. Mendova sa mund të shkoja deri në Golimbas dhe aty mbyllej muhabeti. Por mesa duket i pata bërë llogaritë gabim, se baba Arshiu më ndiqte duke më thënë: "Hajde evlad, mjaft ndenje më të tutë, pa çapu njëherë ku të thashë unë!"

Nuk mund ta gënjeja dot atë baba, i cili pati lënë ato vende gjashtëdhjetë vite më parë dhe mbante të ndezur në atë moshë qiririn dhe dritën e Haxhi Bektash Veliut. I kalova me radhë ato vende të bekuar përmes mendimeve se si mund të kishin qenë ato teqe gjashtëdhjetë vite të shkuar. Por mendja ime s'i ndërtonte dot ato mrekulli siç kishin qenë dikur, sepse vitet ateistë që kaluam kishin lënë gjurmët e tyre. Kur u ktheva këtu në Detroit, sapo zbrita nga avioni, u nisa drejt e në teqe.

Hapa derën, u hodha në krahët e baba Arshiut dhe nxora nga valixhet e mija një degë lofate. "E këputa në "Kurorën e Malit", thashë dhe ja dhurova baba Arshiut. Ky e mori, i vuri fletët në buzë dhe u mori erë. Pastaj më pa mua dhe më tha: "Të qenkan mbushur sytë me dritë!" Unë buzëqesha.

Ndoshta ishte e vërtetë. Sepse kisha vajtur në atë vend të bekuar dhe pata ndenjur gjatë në meditim. Me siguri ajo dritë vinte nga "Kurora e Malit."

Baba Selim Gjïrokastra



Nga Haxhi Baba Sadik Ibro

Baba Selimi ka lindur ne Qytetin e Elbasanit, ne nje familje me tradita te hershme Bektashiane dhe arsimdashese. Baba Selimi ishte nipi i Baba Ali Elbasanit i cili e dha kete femi nga fryma e tij e shenjte, per te ndjekur me vonë dhe gjate gjithë jetes se tij, rrugen mistike te Haxhi Bektashit. Pse jo, te ishte nje drite shpirtërore per te gjithë ata qe do ta ndiqnin ate gjate jetes se tij. Baba Selimi ishte edhe dajua i Ferdi Rexheb Baba, Ai ishte edhe Udherrefenjesi Shpirtëror i ketij te fundit, ishte burimi i asaj drite qe Baba Rexhebi beri te mundur dhe e hapi kete drite hyjnore deri ne token e premtuar ne Detroit te Amerikes ku ngriti Teqene e pare Bektashiane dhe mbajti ndezur kandilin e Haxhi Bektashit ndezur gjate sistemit komunist ne Shqiperi.

Me lejoni te nderuar zonja dhe zoterinj tu rikujtoj nje thenie te murshidit te fakirit Baba Sherif Elbasanit i cili ne fillimet e mija si ndjekes i kesaj udhe me ka thene per kete Kryeshtylle Shenjterie: "Baba Selim Gjïrokastra ka qene dhe do te mbetet nje Shenjtor, ku jeten dhe tere qenien

e tij, ja dedikoi besimit Bektashian dhe popullit Shqiptar pa dallim feje". Vertete keshtu ishte Baba Selimi, qe fakiri dekada me vonë pata miresine te sherbeja disa vite ne Dergjahun e tij, ne ate Teqe ku ai u rrit dhe u arsimua, ne ate Teqe ku ai shpalosi vlerat dhe vyrtytet e tija te larta prej nje Ndjekesi Shembullor dhe prej nje Shqiptari te denje ne luften per largimin e ekupatorit, qe njeri pas tjetrit e kishin shperbere Shqiperine si nje placke te dores se dyte, qe kushdo mund ta perdorte simbas politikave te tij. Baba Selim Gjïrokastra nuk ishte vetem nje Murshidi Qamil (Udherrefenjes i Persosur), por ai ishte edhe nje prind i mire per kedo qe trokiste ne zemren e tij e oqean, qe permblidhte te gjitha dashurite dhe miresite, i mirepriste me bujari te pakrahasuar, sic beri me familjet e medha Shqiptare te te gjithë trevave qe u iternuan ne kalane e gjïrokastrës aso kohe nga pushtuesit Nazi Fashiste. Ai ishte mesuesi i shume djemve nga Gjïrokastra dhe rrethinat e saje, te cilet u mesonte gjuhen shqipe, nga Baba Selim Gjïrokastra kane dale shume mesues neper laberi, po thuaj gati 80% e Dervisheve te tij ish in perhapur neper tere laberine, Permet e Berat si mesues per ti mesuar popullin gjithen e nenës. Baba Selimi ne nje doreshkrim te tij ka shkruar keshtu:

"Nje popull eshte i vdekur, atehere kur nuk njih gjuhen dhe zakonet e te pareve te tij". Vertete nese nje popull nuk njih gjuhen e tij, ai eshte skllavi i dikujt tjetër, dhe vdes cdo dite nga pak. Por, Baba Selimi kete menxyre nuk ja dha popullit te tij, perkundrazi e ushquë ate me besim per gjuhen dhe vatanin e tij. Baba Selimi tashme kishte ndertuar kete tempull miresie brenda vetes me shume sakrifica dhe mundime, por me nje deshire dhe nje dashuri te patjetersueshme per kete vatan ku ne te pasmit jetojme te lire. Jemi te gjithë bashke sot ne kete simpozium ku nder te tjera flitet edhe per kete burrë me bese Shqiptari, per kete burrë qe beri histori ne themelet e Bektashizmit, por, pa harruar asnje moment ne historine e Kombit Shqiptar. Si baba Selimi edhe shume klerike te tjere Bektashian dhe te cdo besimi tjetër ne Shqiperi i kthyen Kultet e tyre ne

stra, simbol mirësie

vatra te gjuhes shqipe dhe te interesave te Kombit Shqiptar.

Fakiri dhe ju te gjithe bashke, mendoj se ndjehemi te privilegjuar qe kemi fatin dhe mundesine te shkruajme apo edhe te degjojme per punen dhe veprat e ketyre burrave Kolloze te Shqiperise, sakrificat dhe mundimet e tyre per besimin qe i perkisnin dhe per kete vatan qe quhet Shqiperi. Ata dhane jo vetem dijet e tyre, por shume prej tyre dhane edhe jeten per idealin e tyre te shenjte sic eshte vatani dhe besimi. Udherrefenjesit e vjeter kane thene: "Sakrifica per ndjekesit e rruges se Muhamed Aliut dhe drites se Haxhi Bektashi Veliut" duhet ti kaperceje kufijte e saje per te arritur qellimin e deshiruar. Themeluesi i Tarikatit Bektashian, Haxhi Bektashi Veliu në një histori të tijën tregon:

Dikur njerëzit i donin shumë mbretërit që pushtonin jo vetëm tokat, por edhe zemrat e tyre. Gjithashtu ata kishin dëshirë të njiheshin dhe të duheshin prej tyre. Për këtë arsye, në ditë të veçanta njerëzit shkonin në Qytet dhe dilnin në praninë e mbretit për t'i servirur atij dhuratat e tyre. Në një ditë kur të pasurit paraqitnin dhurata të çmuara përpara mbretit, edhe një i varfër po kërkonte një dhuratë të denjë për mbretin. Pasi nuk arriti të gjejë asgjë, i vjen ndërmend shtemba me doreza te thyera që kishte në shtëpi. E mbush shtembën me ujin e freskët nga burimi i fshatit dhe niset për tek mbreti.

Rrugës takon dikë i cili pasi mëson se me çfarë po merrej e për ku ishte nisur, në formë fyese i thotë: "A nuk e di ti se froni i mbretit ndodhet mbi burimin e atij uji. Madje edhe uji i burimit tuaj atij i përket!"

I varfri skuqet, fjalët i bëhen lëmsh në grykë, përtypet dhe thotë: "S'prish punë, mbretit i ka hije të sillet si mbret, ndërsa shërbëtorit si shërbëtor. Edhe nëse s'kam një dhuratë të veçantë për mbretin, kam një zemër plot me dashuri dhe dëshirë për t'i servirur atij ujin tim."

Me shtembën e thyer ai del para mbretit. Mbreti sillet ashtu siç i ka hije një mbreti; e gostit atë dhe kur fshatari bën për të dalë, u thotë shërbëtorëve të tij: "Çfarëdo që

të këtë sjellë fshatari, mos e ktheni duarbosh, mbushjani shtembën me pasuri." Haxhi Bektashi Veliu tregime të tilla i vlerëson mjaft bukur. E rrëfen këtë tregim dhe shton: "Edhe nëse vijmë me një kapital të paçmuar, prapë se prapë porta për ku jemi nisur është porta e Allahut."



Verete, Baba Selim Gjirokastra ishte destini i portes se All-llahut, tek ai nuk kishte se si te ndodhte ndryshe, sepse ai tashme ishte shkrirë i teri ne kete dashuri te madhe qe i kishte perkuar tere qenien e tij, dhe ishte kthyer ne nje vendprehje per te gjithë ata qe i'a kishin nevojën, si per pasuri shpirtërore, po ashtu edhe per dije rreth jetes ku ne jetojme. Kur ekupatori Gjerman ishte instaluar ne Kallane e Gjirokastres, nje dite te bukur komandati Gjerman Gestapo shkon ne Teqe te Zallit me nje efuri te madhe duke mos hequr edhe kepucet e renda qe kishte mbathur ne kembe, mbasi Dervishet e njoftojne Baba Selimin per ardhjen e tij ne Teqe, Baba Selimi shprehet keshtu: “Le te vije dushmani, se driten e Zotit do te shohe”.

Vertete kur Gestapo futet ne odane verore te Baba Selimit, nuk sheh gje tjeter vec nje drite verbuese qe vinte nga Posti ku qendronte ai Hyjnori.

Zonja dhe zoterinj!

Ne nuk mund dhe nuk duhet të ndalemi ketu, nuk e kemi luksin të ulemi e të sodisim sukseset e te pareve tane. Sot, më tepër se për çdo gjë tjetër, ne kemi nevojë për një brez të ndërgjegjshëm në përmbushjen e të gjitha detyrimeve ndaj Zotit, një brez që do ta shpëtojë njerëzimin nga përhumbla e ateizmit, injorancës, gabimit dhe anarkisë dhe që do t'i drejtojë ata me besim, njohuri, destinacion të saktë dhe paqe. Cilësitë më të çmueshme të njerëzve të tillë këmbëmbarë janë besimi i tyre dhe përpjekjet për të nxitur të tjerët që ta përfytyrojnë këtë besim. Me besimin dhe përpjekjet e tyre, ata besojnë që do të jenë në gjendje të mposhtin çdo gjë dhe të mbërrijnë tek Zoti, besojnë që mund të arrijnë paqen e vërtetë dhe besojnë se janë të aftë ta kthejnë këtë botë në një parajsë dhe standartet e tyre të lartësohen. Kënaqësia për destinacionin e tyre i bën ata ta kuptojnë jetën dhe shërbimin ndaj veprave dinjitoze si një udhëtim në luginat e parajsës.

Në të vërtetë, me të gjithë veçoritë dhe ndërlikimet që mund të kenë, asnjë sistem tjetër, doktrinë, ose filozofi, nuk ka një ndikim të tillë pozitiv te njerëzimi, siç ka besimi. Kur besimi hyn në zemrat e njerëzve duke u bërë pjesë e qenies së tyre, mendimet që lidhen me universin, objektet dhe Zotin, ndryshojnë menjëherë dhe para tyre shtrihet pafundësia që i lejon ata ta vlerësojnë të gjithë ekzistencën sikur të jenë faqet e një libri të hapur.

Të gjithë këta njerëz, që kanë vështruar përreth gjërat që deri më tani nuk kanë zgjuar interesin e tyre, gjithçka që ka qenë e pajetë dhe e pakuptimtë deri në këtë ditë, menjëherë gjallërohen dhe tani shfaqen si miq e bashkëpunëtorë dhe këto gjëra i përqafojnë. Atëherë ata janë plotësisht të lirë nga qelia e ngushtë e kësaj bote tredimensionale, duke e gjetur vetveten në kërkim të amshimit. Baba Selim Gjirokastra kete gje e verteton me kete thenie

shume te bukur dhe delicate:

“Kur te gjithë ndjekesit e ketij besimi do te jene nje dhe te pandare, ne cdo hap te tyre, ata nuk do te behen vetem udherreferenjes te denje, por ata do te jene edhe drejtues te komuniteteve te ndryshme ku ata do te kene fatin ti sherbejne Besimit dhe Shqiperise”.

Në të vërtetë, të gjithë besimtarët, përmes mendimeve që gjenden në thellësi të identitetit të tyre dhe në përputhje me shkallën e besimit të tyre, bëhen të pakufizueshëm brenda caqeve të tyre. Edhe nëse janë kufizuar në hapësirë dhe kohë, bëhen modele të krijesave të pakufizuara, ngjiten në rangun e qenieve që janë në kufijtë e hapësirës, duke ndjekur melodinë e engjëjve.

Ata ecin krah për krah me shenjtoret, qëndrojnë me ata, vënë këmbët atje ku shenjtoret kanë shkëlur dhe vënë kokën në të njëjtin vend me ta kur falen. Ata përplasjin flatrat në të njëjtin qiell si shpirtrat dhe jetojnë si krijesa qiellore në një gjendje njerëzore.

Zemrat e tilla lënë mënjane individualitetet me evolimin dhe ekspansionin e ndjenjave njerëzore, ata bëhen, në një rrugë, një personalitet dhe hapin krahët për të gjithë besimtarët, ata shtrëngojnë duart me çdo njeri dhe përshëndesin plotësisht krijimin me çiltërsinë e ndjenjave të tyre. Zoti i do këta njerëz, dhe ata e duan Zotin. Burra si Baba Selimi ishin rob ne dashurine e Krijuesit, Zotit, Nje



e te vetem, pa shok dhe ortak. Ata ishin bijte e ketij vatani dhe sherues te plages se shpirtit njerezor. Ai ishte filli lidhes ne fjalën hyjnore e cila perciell cdo mesim me dashuri, cdo vyrtyt me embelsi dhe cdo detyre me keshillime te ngrohta. Celesi i gjithcka eshte ne doren e Zotit, thesaret e tokes jane ne pranine e tije hyjnore dhe ai eshte zoteruesi i gjithckaje. Sovran mbi cdo pasuri. Kurse ne njerezit jemi pors i nje trup pa jete ne duart e veprave tona. Zoti na befte te bindur e te qendrueshem ne kete ndjenje e mendim, te perulur me shpirte perpara veprave te larta njerezore dhe hyjnore te ketyre dishepujve te miresise dhe te All-llahut. Nese nje bashkesi ecen ne drejtim te kenaqesise se Zotit te madheruar, pamvaresisht nese eshte e suksesshme apo jo ne punet qe kryen, do te thote se ka fituar kenaqesine dhe dashurine e Zotit te vertete.

Çdo hap të hedhur në emër të shërbimeve ndaj Fesë mund ta vlerësojmë po kështu. Veç kësaj, të bashkuarit e njerëzve të ndryshëm e të larmishëm rreth një ndjenje e mendimi të përbashkët për të shërbyer e punuar së bashku për një qëllim miresie dhe vellazerie te shendoshe pa ndasira dhe egoizma, është një shfaqje e mirësisë hyjnore. Njëherazi është edhe një mundësi e rëndësishme në fushën e bashkimit, të vëllazërimit e të mirësisë që kemi marrë si mesime shume te vyera nga udherrefenjesit tane te persosur si Baba Selim Gjirokastra e pasardhesit e tij



nder vite e dekada.

Profeti ynë fisnik shprehet kështu në një hadith të tijin: “Në këtë botë qendro si një i huaj, ose si një kalimtar.” Ata njerëz fatbardhë që janë gjuhëzuar në ballë të altarit të dashurisë dhe që jetën ia kanë kushtuar përhapjes së saj, nuk kanë lënë edhe një hapësirë të vogël në fjalorin e tyre për fjalë të tilla si urrejtje, mëri, komplot ose zemërim, dhe, po ashtu, nëse mendimet vënë vërtet në rrezik jetën e tyre, ata kurrë nuk janë mbushur me zemërim. Kokeulur dhe të përvojatur, të mbushur me dashuri, ata kurrë nuk kanë përshëndetur gjë tjetër veç saj. Kur ata lartësohen, ndjenja e urrejtjes kërkon të gjejë një strehë ku të fshihet, mëria bëhet ziliqare, zmburur prej goditjeve, dorëzuar prej dashurisë. E vetmja formulë që mbajti të bashkuar Klerin e cdo besimi dhe Patriotet Shqiptare nder ato vite te erreta te vendit tone , ishte dashuria per Kombin dhe Besimin

Shenjtorët kanë provuar të mbledhin së bashku shpirtrat rebelë dhe të padisciplinuar, përhapur kudo si fletë të palidhura, ata kanë shfrytëzuar dashurinë për të inicuar sjellje njerëzore te të tjerët. Pra, nuk ka dyshim që një njeri që është blinduar me dashuri, nuk kërkon tjetër armë. Sigurisht, dashuria është mjaft e fortë për të ndaluar një plumb, madje, një gjyle topi. Interesi ynë në kushtet tona dhe dashuria jonë për njerëzimin - është aftësia për të përqaftuar krijesat – është besimi në njohuritë dhe inteligjencën tonë për të njohur esencën, aftësia për të zbuluar veten dhe për të ndërë lidhje me Krijuesin e gjithësisë. Në paralel me aftësinë për të zbuluar dhe ndërë thellësitë tona të brendshme dhe potencialin e fshehtë brenda esencës tonë, ne gjithashtu do të jemi në gjendje të çmojmë dhe të tjerët që zotërojnë të njëjtin potencial. Për më tepër, pikërisht sepse këto vlera të brendshme janë të lidhura drejtpërdrejt me Krijuesin, udherrefenjesit tane na kane ushqyer respekt për gjërat e çmueshme e të fshehura në çdo krijesë, ne do të fillojmë ta shohim çdo gjë të gjallë prej një perspektive tjetër dhe në një mënyrë tjetër. Në të vërtetë, niveli i inteligjencës tonë dhe vlerësimi për një tjetër varet nga njohja sa më e mirë e cilësive dhe pasurive që zotëron çdo njeri tjetër. Ne mund ta përmbledhim këtë koncept në një ide bazuar në një thënie të Profetit, paqja dhe bekimi qofshin mbi të, sipas së cilës thuhet: “Një besimtar është pasqyrim i nje besimtari tjetër.” Nëse jemi në gjendje t’ia dalim në krye kësaj si edhe të jemi të aftë të kuptojmë dhe të çmojmë pasuritë e fshehura brenda ketyre, ne do të kuptojmë gjithashtu si janë lidhur këto pasuri me Zotin e tyre të vërtetë dhe në këtë mënyrë ne do të pëlqejmë çdo gjë në këtë gjithësi që është e bukur, e dashur, ose të dashurit që bëjnë pjesë tek Ai. Një shpirt që mund ta kuptojë këtë shprehje të thellë ishte Baba Selim Gjirokastra, i cili do të bënte siç bëri Rumi që na rrëfeu prej gjuhës së zemrës keto

thesare hyjnore:

*“Afrohuni, afrohuni dhe bashkohuni me ne,
se ne jemi populli që jemi lidhur me dashuri pas Zotit!
Afrohuni, afrohuni përmes derës së dashurisë
dhe bashkohuni e qëndroni me ne!*

Afrohuni,

Le të flasim me njëri-tjetrin nëpërmjet zemrave tona!

Le të flasim në heshtje, pa veshë e pa sy!

Le të qeshim së bashku pa gojë ose pa zë!

Le të qeshim së bashku si trëndafila!

Ja mendimi,

*Le të shohim çdo njeri tjetër që nuk nxjerr
asnjë fjalë apo tingull.*

Më pas ne jemi të gjithë të njëjtë,

Le t’i thërrasim çdo tjetri prej zemrave tona, ne nuk do të përdorim buzët ose gjuhën tonë. Si janë bashkuar duart tona së bashku, po ashtu të flasim dhe ne me zemrat tona të bashkuara.

Ashtu sic bene ne ato kohe baba selimi me vellezerit e tij shpirtëror, Brenda llojit dhe jashte tij, per te miren e kombit dhe gjuhes se nenës, per te miren e gjithe Shqiptareve, qe vuanin nga thundra Nazi/Fashiste!


Në të vërtetë, jemi ne njerëzit ata qe duhet te mblidhen rreth pikëpamjeve të përbashkëta, të tilla si Zoti është Një, Profeti dhe feja, u ngjasojnë gjymtyrëve të një trupi. Dora nuk mund të kërkojë të krahasohet me këmbën, gjuha nuk mund të kritikojë buzën,

sytë nuk mund të shohin shkarjet e veshëve dhe zemra nuk mund të përlshet me mendjen.

Ne duhet ta pastrojmë udhën për të bashkuar njerëzit dhe kjo është një prej rrugëve të mëdha në të cilën Zoti u dhuron sukses njerëzve në këtë botë dhe kjo është rruga me të cilën Ai e shndëroi figuren e Baba Selimit dhe vendprehjen e tij në një Parajsë. Sepse Baba Selimi duke edhe tuar në këtë rrugë, dera e parajsës per të u hap gjerësisht ne mendjen dhe ne tere trupin e tij qelibar, sa ishte ne kete jete, dhe ne amshim ku ai hyjnor banon.

Se fundmi me lejoni tu therras me te forte thoshte Baba Selimi ne nje mbledhje qe u mbajt ne Teqene e Zallit ne shtator te vitit 1939:

Ne duhet te largojmë të gjitha mendimet dhe ndjenjat që na ndajnë dhe të nxitojmë të përqafojmë njëri-tjetrin me ndjenjën e dashurisë, te bashkimit dhe te vellazerimit, per nje besim te paster dhe te nje vellazeri te shendoshe.!



Festa tradicionale e pavarësisë sonë kombëtare mblodhi këto ditë në kishën Shën Palit në Rochester SHBA, personalitete të shquara jo vetëm nga SHBA, por edhe nga Kosova, Mali i Zi, Maqedonia Veriore dhe Shqipëria, për të ndarë së bashku gjithçka që fal vijmësia e lirisë së një kombi. Ra në sy dukshëm që në stendën e librave të rinj ishte edhe libri “100 vjet pranë Zotit” i autorit Syrja Xhelaj, ardhur enkas nga Tirana. Në parathënien e librit autori thotë: “Mu duk si një grishje për në universin mistik, teksa bashkëbiseduesi im, një studiues amerikan, nisi të më flasë aq rrjedhshëm për ezoterizmin e brishtë të baba Arshi Bazajt. Ishte mesnatë dhjetori e vitit 2016 dhe në Çikago, dëborë zbardhte gjithçka. Bluja e thellë

Njëqind vjet pranë Zotit

Në stendën e librave të Kishës Shën Pali në Rochester SHBA, paraqitet edhe libri i autorit Syrja Xhelaj për baba Arshi Bazaj

e oqeanit, përmes një mërmërimë parahistorike, më dukej se u gëzohej simetrisë së dritareve të metropolit të ftohtë. Biseda për këtë baba durimmadh vazhdoi edhe pak, për t'u mbyllur dhembshurisht prej mikut tim, me idenë se në themele të ezoterizmit është padyshim akti madhor i shpalljeve. Për shkak të konteksteve domethënës, por të palexueshëm prej syrit të lirë, këto nuk mund të kundrohen prej gjithë dashuruesve të tarikatisë. Tek dervishët dhe baballarët bektashianë, një shqisë e çuditshme, ka mundur të deshifrojë në shekuj, kodet e këtyre shpalljeve, përmes Kur'anit, dimensionit profetik të Haxhi Bektash Veliut, apo mençurisë së imamëve. Pas kësaj bisede, u ndjeva si i përhumbur në rrjedhat e qeta të eposit bektashian.

Gjithsesi më mbeti një peng. Kisha kaluar dhjetëra netë me baba Arshiun, kisha në bllokun tim qindra faqe me rrëfenja të tij, duke qenë gjithmonë i shastisur prej sinqeritetit që përcillte ngjarjet. Kisha imagjinuar jetë klerikësh të ndriçuar befas nga kujtesa e tij, siç ndriçohen konturet e maleve prej shkrepimave, figura të shquara nacionalistësh shqiptare, mbi të cilët koha e mbrapshtë hodhi llohë e baltë pareshtur. Pata kuptuar ndërkaq përmes dritës së dashurisë që mbanin të ndezur vështrimin e tij, se dervishi fatlumë, ishte udhëzuar aq mrekullisht në burimet e kuptimeve të fshehta, prej myrshidit, baba Rexhebit, emblemë e gjithkohëshme e besnikërisë ndaj parimeve hyjnorë, në bektashizmin botëror të shekullit të njëzetë. Por krejt papritur, kjo letargji gjumëndjellëse, u kris dhe rrokullis prej një bisede, në mesnatën llahtarisht të bukur, të Çikagos.

Rrëfenjat, përjetimet, zhvendosjet e ngjarjeve si në tablotë homerike, të tërhequra me njëra – tjetrën nga fuqitë atomike të shpirtit, më dhanë shtysën e

këtij libri të dytë për baba Arshiun. E konceptova si vazhdim të një bisede, fillin e së cilës nuk mund ta brejë asnjë akt natyror. Kënaqësitë e bisedave me njerëz që e patën njohur këtë baba hallemadh, i jetova deri në fund dhe jam i bindur së brendshmi, se kurrë nuk e kam lëshuar veten kaq lehtësisht, në dehjet nga vera e diturve të Khajamit dhe miqve të tjerë mistikë.

Shumë prej të diturve, të djeshëm dhe të sotëm të Islamit, bashkohen në idenë se filozofia profetike ka bashkudhëtuar me tarikatat, qysh në shfaqjen e tyre të parë në horizontet fetare aziatikë. Veçmas, kjo e tarikatisë bektashianë, nënkupton vëllazërimin njerëzor përmes dashurisë së Krijuesit. Mistika, si një prej veçorive më të spikatura të nënqiejve islamë, ka gjetur shprehjen e vet të mrekullueshme, përveç të tjerave edhe tek njëqind vitet e baba Arshiut.

I përmenda këto, sepse veçanërisht sot, kur prirjet globale tentojnë “çlirimin” e natyrës nga barra e mundimshme e besimit, ndarjen e pakuptimtë nga I Gjithëdijshmi, mosrespektin asgjësues ndaj entitetit hyjnor të saj, ndihma e të Mësipërmëve nuk ka të çmuar. Ndër të parat nuanca që kapja fluturimthi me bashkëbiseduesit e këtij libri, ishin ato që në çdo situatë, kur i kërkohej ndihmë, interpretimi i baba Arshiut ishte shprehimisht shpirtëror. Ky akt, m'u rikthye si një shpërblim lehtësues në punën time. Në bektashizëm (me çfarë kam kuptuar deri më sot) çdo virtut është religjioz. Kjo nënkupton lirinë e shpirtit racional, ose thënë më shkoqur, të jesh në radhë të parë, i drejtë me veten tënde. Vetëm në paqe me veten, mund të perceptosh e synosh atë universalen, të përjetshmen”.

*Veronika Smajli
Rochester, dhjetor 2019*

Let support the prays on the living reality



It is my great honor and pleasure to participate in this event and allow me to wish you in my personal name also in the name of Bektashis from all the world: May the Great Lord fulfill every wish to You, Your spiritual families and Your nations!

Today's summit, held in the context of Jubilee celebrations of Sheikh-ul-Islam Allahshukur Pashazade, is certainly another opportunity for us, not just to meet each other, not only to talk about those who "hurt our souls", but also to define our own ways of facing challenges. We have had and will always need each other's word, for it is the word that has come down to us in its eternal greatness from the Holy Books, it is the word of God that gives us the true meaning of today's life and the life of 'ahiret'. It is the word that unites us in this diverse world.

Our great and wonderful Muslim family has, over

the centuries, experienced endless displays of compassion, dialogue, human and religious understanding, because at the substance of our faith is precisely this tolerance that has fed us through the generations.

In this hall, we all know that in the third year of Hijri, when our blessed Prophet entered Mecca, all unbelievers hid or wanted to escape from all the bad things that they made to the Muslims. But our Prophet, the messenger of the faith of the Supreme Allah, always manifesting the ideas of mercy and love among the people, said to all the people: "O people! We have indeed created you from a male and a female, made you peoples and tribes to know one another, and there is no doubt that in Allah Most High, the Most Honorable from all of you, beware of sins and Allah is All-Knowing is the one who know everything in details." (Qur'an, 49:13).

There is no doubt that such a sensory substance,

such as the human brotherhood, has accompanied the Muslim family over the centuries, building not only its foundations, but all that precious building enlightened by Islam. The idea of peace in both worlds, the embodiment of, the embodiment of a brotherhood beyond colors, races or religions, the profound and conscious respect for nature and its Creator, made possible the advancement of our religion as well as its embrace today, in more than a billion believers. Even when it was anathematized and attacked in various places and times, Islamic tradition always appeared coherent with its most essential features and in particular with universal mercy.

Dear attendees of this respected audience!

We are all aware of the challenges that human society is facing today, challenges that, if not weighed down in the “control” of the soul, will put us in front of unforeseen dramas. The times we are passing by are increasingly revealing the problems we have with nature, forgetting in many cases that this Creator’s gift cannot be wasted on the appetites of notorious oligarchs. We have a problem with removing youth from the cult objects, no doubt attracted by globalism and secularist practicality. We have problems with the poverty of millions of hungry in the face of the indifference of millionaires or “modern” societies, which overlook the right to live, just as we are all susceptible to the regional wars that are taking hundreds of thousands of innocent lives every day.

All of these challenges, of course, are complex

and require not only strong capacities to overcome, but also a permanent and energetic interaction of governments and world political leadership. But what I personally think is that our role, the role of religious leaders, more than today, must be sensitive and contributory, precisely to the idea that before any economic, political or social mechanism, we must seek help the Lord. Our prayers, based on today’s realities, brought from pure souls, multiplied in the human dimension of billions of believers, I believe will contribute to overcoming today’s crises.

Since I currently lead the Bektashi tariqat, let me tell you that this tariqat, which was born eight hundred years ago to this day, has been distributed among believers around the world as a spirit of eternal brotherhood. Bektashi communities, identified today in 31 countries, from Asia to the United States, have been able to identify themselves as brothers and sisters with any other religious community, at any time through their love and deep devotion to Islam and to Haji Bektash Velii. For nearly nine decades, the Bektashi Holy See has moved from Turkey to settle in Tirana-Albania, and this century has proven that we remain conscious of the historical mission, not only of believers, but primarily for the progress of Islam, in the Balkans and beyond. We will contribute to the last heartbeat of the universality of Islam and human peace.

God bless you all!



URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE

BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË

KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE

NR.136 DHJETOR 2019

*Redaksia e revistës
"Urtësia" urojnë lexuesit
dhe bashkëpunëtorët e saj:
Gëzuar 2020*